

**PËRFSHIRJA E  
FËMIJËVE DHE TË  
RINJVE ME AFTËSI  
TË KUFIZUARA  
NË SHKOLLA  
TË MESME TË  
REGULLTA**

Raporti i hulumtimit



Република Македонија  
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ  
Republika e Maqedonisë  
AVOKATI I POPULLIT  
Republic of Macedonia  
O M B U D S M A N



**PËRFSHIRJA E  
FËMIJËVE DHE TË  
RINJVE ME AFTËSI  
TË KUFIZUARA NË  
SHKOLLAT E  
RREGULLTA TË  
MESME**

Raporti i hulumtimit



Ky dokument i përfshin aktivitetet e zbatuara nga Avokati i Popullit dhe Hapni dritaret, me ndihmë financiare nga Bashkimi Evropian dhe UNICEF-i. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë dokument nuk duhet në asnjë mënyrë të konsiderohen si pasqyrë e qëndrimeve zyrtare të Bashkimit Evropian ose UNICEF-it. Bashkimit Evropian nuk është përgjegjës për përdorimin eventual të informacioneve të këtij dokumenti.”



Ky projekt  
financohet nga  
Bashkimi Evropian





# PËRMBAJTJA

7	<b>HYRJA</b>
9	<b>METODOLOGJIA E HULUMTIMIT</b>
9	Lënda dhe qëllimet e hulumtimit
9	Përcaktimi i termave të përdorur
10	Metodat e hulumtimit
10	Karakteristikat e ekzemplarit
16	Korniza kohore
17	<b>ANALIZA E KORNIZËS LIGJORE</b>
17	Korniza dhe standardet ndërkombëtare
18	Korniza ligjore kombëtare
22	<b>GJETJET KRYESORE NGA HULUMTIMI NË TERREN</b>
22	Përfaqësimi i nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin e mesëm të rregullt
28	<b>GJITHËPËRFSHIRJA E SHKOLLAVE</b>
36	Përvoja dhe praktika
51	<b>KONKLuzionET</b>
53	<b>REKOMANDIMET</b>
55	<b>SHTOJCA</b>





# HYRJA

Hulumtimi për përfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në shkollat e rregullta të mesme në shtet u zbatua nga ana e Avokatit të Popullit të Republikës së Maqedonisë, me mbështetje financiare nga Programi IPA i Bashkimit Evropian dhe UNICEF-it, në bashkëpunim me Shoqërinë për teknologji ndihmëse “Hapni dritaret” nga Shkupi.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi ishte shqyrtimi i gjendjes aktuale në lidhje me përfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në shkollat e rregullta të mesme në shtet, si bazë për përcaktimin e rekomandimeve për përmirësim të gjithëpërfshirjes në sistemin arsimor në vend.

Gjetjet dhe njohuritë e fituara kontribuojnë në lehtësimin e mungesës aktuale të të dhënave statistikore mbi përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollat e rregullta të mesme, por edhe në sistemin arsimor në përgjithësi. Pikërisht mungesa e të dhënave adekuate dhe dokumentacioni i pamjaftueshëm i praktikave dhe arritjeve më të mira, nga njëra anë, dhe sfidat dhe mangësitë e zgjidhjeve dhe modeleve aktuale, në anën tjetër, pengojnë planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave

arsimore publike. Për këtë arsye, raporti i hulumtimit është një kontribut në debatin publik për zgjidhje sistematike, të bazuar në fakte dhe prova.

Ky hulumtim është plotësim i një studimi të ngjashëm nga Avokati i Popullit mbi përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin fillor të rregullt, të botuar në vitin 2016. Raporti është pjesë e përpjekjeve të Avokatit të Popullit për të monitoruar dhe inkurajuar vazhdimisht përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shoqërinë në tërësi.



## METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

### Lënda dhe qëllimet e hulumtimit

**Lënda** e këtij hulumtimi është përfshirja e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në shkollat e rregullta të mesme në vend.

**Qëllimet** konkrete të përcaktuara përpara hulumtimit ishin:

- 1) Të sigurohet pasqyrim mbi përfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në shkollat e rregullta të mesme.
- 2) Të përcaktohet gatishmëria e shkollave të rregullta të mesme për të siguruar pjesëmarrje aktive dhe mundësi të barabarta arsimore për nxënësit me aftësi të kufizuara; dhe
- 3) Të identifikohen mundësitë dhe nevojat për përmirësim të mëtejshëm të gjithëpërfshirjes në shkollat e rregullta të mesme në vend.

### Përcaktimi i termave të përdorur

Për qëllimet e këtij hulumtimi, termi **“nxënësit me aftësi të kufizuara”** nënkupton nxënësit që përballen me një nga llojet e mëposhtme të pengesave:

- kufizime fizike (vështirësi në lëvizjen e krahëve, këmbëve ose të gjithë trupit, paralizë cerebrale, përdorimin e mjeteve ndihmëse për lëvizje si karroca etj.)
- përkufizime intelektuale (pengesa në zhvillimin intelektual),
- dëmtime shikimi (të cilat janë me natyrë më të vështirë dhe pengojnë nxënësin në ndjekjen e mësimdhënies),

- dëmtimi i dëgjimit dhe/ ose i të folurit (që janë me natyrë më të vështirë dhe pengojnë nxënësin në ndjekjen e mësimdhënies),
- ndonjë përkufizim i kombinuar (kombinim i disa pengesave të ndryshme),
- autizmi (spektri autistik i çrregullimeve), dhe
- gjendje të tjera të ngjashme që shkaktojnë vështirësi gjatë mësimin (hiperaktivitet, disleksia, disgrafia, diskalkulia etj.)

Duhet theksuar se termi “nxënës me nevoja të veçanta arsimore” (NVA) përdoret në arsim si sinonim për “nxënësit me aftësi të kufizuara”. Megjithatë, termi “nxënësit me nevoja të veçanta arsimore” ka një kuptim më të gjerë dhe përfshin kategori të ndryshme të nxënësve të cilët kanë nevoja të veçanta në procesin arsimor, për shembull, nxënësit të cilët nuk e flasin gjuhën mësimore ose nxënësit tepër të talentuar. Prandaj, termi “nxënës me aftësi të kufizuara” përdoret në këtë hulumtim për të theksuar se fokusi i hulumtimit është i vendosur te nevojat e veçanta arsimore të bazuara në aftësinë e kufizuar të nxënësve.

**“Teknologjia ndihmëse informatike”** (shkurtuar: teknologjia ndihmëse) përfshin pajisjet ose produktet harduerike si dhe përshtatjet softuerike të pajisjeve kompjuterike të cilat e mundësojnë dhe e lehtësojnë përdorimin e kompjuterëve nga personat me aftësi të kufizuara. Shembuj të pajisjeve kompjuterike ndihmëse përfshijnë:

- tastiera me taste të mëdha,
- trakbol,
- leva (xhojstik),
- klikim i ndarë,
- lexuesit e ekranit, etj.

“**Shkolla e mesme**” përdoret për përcaktimin e shkollave të rregullta të mesme në vend, duke përfshirë edhe shkollat e mesme të muzikës, baletit, sportit dhe fiskulturës, por duke përjashtuar shkollat e mesme të posaçme për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Këto përkufizime specifike të termave të përdorura në hulumtimin u janë shpërndarë dhe u janë shpjeguar të anketuarve të përfshirë në këtë hulumtim.

### Metodat e hulumtimit

Hulumtimi ishte zbatuar nëpërmjet metodave: hulumtim nga zyra, anketa, intervista dhe fokus grupi.

**Hulumtimi nga zyra** përfshiu rishqyrtim të kornizës ligjore dhe politikave publike të cilat i përkasin përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e rregullta të mesme. Pika fillestare në analizën ishin dispozitat dhe standardet e dhëna nga Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe Deklarata Salamanka e UNESCO-s mbi arsimin gjithëpërfshirës dhe shkallën e harmonizimit të kuadrit ligjor kombëtar me këto dy dokumente. Gjithashtu, janë marrë në konsideratë burimet përkatëse sekondare të informatave, si dhe raportet ekzistuese nga hulumtimet, studimet etj. Lista e dokumenteve të përfshira në hulumtim është dhënë në Shtojcën 1.

Në shkollat e rregullta të mesme u

zbatua anketë në lidhje me të kuptuarit e tyre, përvojat (praktikat) dhe qëndrimet (si institucion) lidhur me përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara. Për anketën u përgatit një pyetësor, me një kombinim të pyetjeve të mbyllura, gjysmë të hapura dhe të hapura, të bashkangjitura në Shtojcën 2.

Janë zbatuar intervista gjysmë të strukturuar me personat përgjegjës nga një numër i njëjtë i shkollave të rregullta të mesme. Intervistat u bënë në vetë shkollat dhe na mundësuan që të marrim informata dhe sqarime më të hollësishtme rreth kuptimeve, përvojave dhe qëndrimeve të shkollave në lidhje me inkluzionin. Pyetjet e përdorura në intervistat janë të bashkangjitura në Shtojcën 3.

Nëpërmjet fokus grupeve janë përfshirë tri kategori të të anketuarve: mësuesit dhe përfaqësuesit e shërbimeve profesionale në shkollat, prindërit e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nxënësit me aftësi të kufizuara. Vëmendja u fokusua në identifikimin e përvojave të të anketuarve dhe sfidat, nevojat dhe mënyrat e mundshme për të forcuar edhe më tej gjithëpërfshirjen në arsimin e mesëm. Çështjet e adresuara në fokus grupet janë të bashkangjitura në Shtojcën 4.

### Karakteristikat e ekzemplarit


Nëpërmjet tri metodave të përdorura në hulumtimin në terren - anketa, intervista dhe fokus grupet – u përfshinë ekzemplarët përfaqësues me karakteristikat e mëposhtme në aspektin e fushës dhe strukturës:

**Anketa** mbuloi 86 përqind të të gjitha shkollave të mesme të rregullta në vend që dërguan përgjigjet e pyetësorit, të



vërtetuara dhe të nënshkruara nga drejtori ose personi tjetër i autorizuar i shkollës. Në numra absolutë, nga 107 shkolla gjithsej (duke përfshirë këtu edhe shkollat

e muzikës, baletit, arteve dhe sportit, dhe gjimnazet), të cilave iu dërgua pyetësori, përgjigje kthyen gjithsej 92 shkolla.




### Pasqyra 1:

#### Numri dhe përqindja e shkollave të rregullta të mesme të përfshira në hulumtimin me anketa

Në vitin shkollor 2016/17, gjithsej 64.298 nxënës mësuan në shkollat që dorëzuan përgjigjen e pyetësorit. Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës, numri i përgjithshëm i nxënësve në shkollat e mesme të rregullta në atë vit shkollor ishte 76,394 nxënës. Prandaj, në shkollat e mbuluara nga anketa mësuan 84.2 përqind të numrit të përgjithshëm të nxënësve në shkollat e mesme të rregullta

në vend<sup>1</sup>. Në vitin akademik 2017/18, numri i përgjithshëm i nxënësve të regjistruar në fillim të vitit shkollor ishte 62,251 (këto të dhëna nuk gjenden në faqen e internetit të Entit Shtetëror të Statistikave, pasi që Zyra i paraqet këto të dhëna pas përfundimit të vitit shkollor).



### Pasqyra 2:


#### Numri i përgjithshëm i nxënësve në shkollat që i janë përgjigjur pyetësorit<sup>1</sup>

Shkollat që i janë përgjigjur pyetësorit (92) janë të vendosura në të tetë rajonet planore në

<sup>1</sup> Burim: Enti Shtetëror i Statistikës, Statistika nëpër fusha: Arsim dhe shkencë, <http://www.stat.gov.mk/OblastOpsto.aspx?id=5>, vizituar me datë 28.11.2017

vend: shumica e shkollave janë nga rajoni i Shkupit (25), kurse më pak pyetësorëve u janë përgjigjur nga rajoni juglindor dhe verilindor (shtatë). Ky ndryshim në favor

të shkollave nga rajoni i Shkupit është për shkak të faktit se shumica e shkollave të vendit janë të vendosura në rajonin e Shkupit.




### PASQYRA 3:

Shpërndarja sipas rajoneve planore të shkollave të mesme të rregullta të cilat i janë përgjigjur pyetësorit

Shumica e shkollave që i janë përgjigjur pyetësorit (92) kanë mësimdhënie në gjuhën maqedonase (54 ose 58.7 për qind); numri më i vogël i tyre (katër ose

4.3 për qind) janë shkolla dygjuhësore që mësojnë në gjuhën maqedonase dhe turke.




### PASQYRA 4:

Struktura e shkollave të cilat i janë përgjigjur pyetësorit sipas gjuhës mësimore

Sipas llojit të arsimit, shumica e shkollave që i janë përgjigjur pyetësorit (92) ofrojnë arsim të mesëm profesional (39 ose 42.4%);

katër shkolla (4.3 përqind) ofrojnë arsim të mesëm artistik ose të fizikuturës.



#### PASQYRA 5:

Struktura e shkollave të cilat i janë përgjigjur pyetësorit sipas llojit të arsimit

**Intervistat** përfshinë 16 shkolla të rregullta të mesme, të përzgjedhura nga ekipi hulumtues në konsultim me Avokatin e Popullit dhe UNICEF-in. Përzgjedhja është bërë në bazë të përgjigjeve të marra nga pyetësorët, duke marrë parasysh disa faktorë:

- rajonin ku ndodhen shkollat;
- llojin e arsimit që ofrojnë;
- gjuhën e mësimi; dhe
- përfaqësimin e nxënësve me aftësi të kufizuara në shkolla.

U përfshinë shkolla të mesme nga të gjitha rajonet në vend.

Rajon planor	SH	L	VL	RV	PE	PO	JP	JL	Gjithsej
Numri i shkollave të intervistuar	7	2	2	1	1	1	1	1	16

#### PASQYRA 6:

Numri i shkollave të mesme të intervistuar sipas rajonit<sup>2</sup>

U përfshinë shkolla që ofrojnë lloje të ndryshme arsimit.

Lloji i arsimit	Gj	P	Gj dhe P	A	Gjithsej
Numri i shkollave të intervistuar	3	8	3	2	16

#### PASQYRA 7:

Numri i shkollave të mesme të intervistuar sipas llojit të arsimit<sup>3</sup>

2 SH-Rajoni i Shkupit; L-lindor; VL-verilindor; RV-Rajoni i Vardarit; PE-Rajoni i Pellagonisë; PO-Rajoni i Pollogut; JP-jugperëndimor; JL-juglindor  
3 Gj-gjimnaz; P-profesional; Gj dhe P – gjimnaz dhe profesional; A-artistik

Të anketuarit ishin përfaqësues nga shkollat që kanë mësimdhënie në gjuhë të ndryshme mësimi, si dhe shkolla dy dhe tregjuhësore.

Gjuha arsimore	mk	shq	mk, shq	mk, tr	mk, shq, tr	Gjithsej
Numri i shkollave të int.	10	2	2	1	1	16

#### PASQYRA 8:

Numri i shkollave të mesme të intervistuar sipas gjuhës mësimore<sup>4</sup>

Sa i përket përfaqësimit të nxënësve me aftësi të kufizuara, sipas përgjigjeve të paraqitura në pyetësorë, nga 16 shkollat e intervistuar:

- 11 përfshijnë nxënës me aftësi të kufizuara; dhe
- 5 nuk përfshijnë nxënës me aftësi të kufizuara.

Nëpërmjet **tri fokus grupeve** u përfshinë gjithsej 28 persona nga tri grupe të ndryshme: nxënësit me aftësi të kufizuara, prindërit e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe mësuesit dhe përfaqësuesit e shërbimeve profesionale të shkollave. Përzgjedhja e pjesëmarrësve në fokus grupet u bë nga ekipi hulumtues, në konsultim me Avokatin e Popullit dhe UNICEF-in, dhe u bënë përpjekje për të siguruar përfaqësim adekuat sipas disa karakteristikave të ndryshme.

Fokus grupet me nxënësit me aftësi të kufizuara përfshinë nëntë të anketuar në moshën prej 15 deri në 18 vjet, me strukturë si në vijim:

Pesë nga të anketuarit ishin femra, dhe katër ishin meshkuj.

Sipas llojit të aftësisë së kufizuar, katër të anketuar përballeshin me aftësi të kufizuara fizike, dy me autizëm dhe një me çrregullime të spektrit autik, dy me aftësi të kufizuara intelektuale dhe një me dëgjim të dëmtuar.

Sa i përket përfshirjes në arsimin e mesëm, katër të anketuar ishin nxënës të vitit të parë, dy nxënës të vitit të dytë dhe një nxënës i vitit të tretë; dy nga të intervistuarit, megjithatë, përfunduan arsimin e mesëm në vitin e kaluar shkollor.

Katër nga të anketuarit ishin nga Rajoni i Shkupit; pesë të tjerët ishin nga Rajoni i Lindor, Juglindor dhe Rajoni i Vardarit.

<sup>4</sup> mk – gjuha mësimore maqedonase; shq – gjuha mësimore shqipe; mk, shq – gjuhët mësimore maqedonase dhe shqipe; mk, tr – gjuhët mësimore maqedonase dhe turke; mk, shq, tr – gjuhët mësimore maqedonase, shqipe dhe turke



NUMRI I NXËNËSVE SIPAS:										
Gjinia		Përfshirja në arsimin e mesëm					Lloji i pengesës			
f	m	I	II	III	IV	Mbar.	KF	A	KI	DD
5	4	4	2	1	0	2	4	2	2	1

**PASQYRA 9:**

Struktura e nxënësve me aftësi të kufizuara – pjesëmarrës në fokus grup<sup>5</sup>

Fokus grupi i prindërve të nxënësve me aftësi të kufizuara përfshinte nëntë të anketuar me strukturë si në vijim:

Shtatë ishin femra, dhe dy ishin meshkuj. Katër nga të anketuarit ishin prindër të nxënësve që përballohen me autizëm dhe çrregullime të spektrit autik. Dy ishin prindër të nxënësve me aftësi të kufizuara fizike, dhe i njëjti numër i prindërve të nxënësve me aftësi të kufizuara intelektuale. Një pjesëmarrës ishte prind i një nxënësi me dëgjim të dëmtuar.

Sa i përket përfshirjes në arsimin e mesëm, pesë të anketuar ishin prindër të nxënësve të vitit të parë dhe dy të nxënësve të vitit të dytë. Fëmijët e dy prindërve- pjesëmarrësit në fokus grupin përfunduan shkollimin e mesëm në vitin e kaluar shkollor.

Gjashtë nga të anketuarit ishin nga Rajoni i Shkupit; tre të tjerët ishin nga Rajoni i Vardarit dhe nga Rajoni Juglindor.

NUMRI I NXËNËSVE SIPAS:										
Gjinia		Përfshirja në arsimin e mesëm					Lloji i pengesës			
f	m	I	II	III	IV	Mbar.	KF	A	KI	DD
7	2	5	2	0	0	2	2	4	2	1

**PASQYRA 10:**

Struktura e prindërve të nxënësve me aftësi të kufizuara – pjesëmarrës në fokus grup<sup>6</sup>

Fokusgrupii mësuesve dhe përfaqësuesve të shërbimeve profesionale përfshinte dhjetë të anketuar - të gjithë femra, me këtë strukturë:

Gjashtë prej tyre kanë punuar si bashkëpunëtoresh profesionale -defektologe në shkollat e mesme të rregullta, dy ishin arsimtare, gjithashtu morën pjesë në një pedagogje dhe një psikologje.

Pesë nga të anketuarat ishin nga Rajoni i Shkupit, tri nga Rajoni i Vardarit dhe një nga Rajoni Lindor dhe Verilindor.

- 5 Mbar.-kanë mbaruar arsimin e mesëm të rregullt; KF- aftësi të kufizuara fizike; A- autizëm dhe çrregullime të spektrit autik; KI- aftësi të kufizuara intelektuale; DD- dëgjim të dëmtuar
- 6 Mbar.-kanë mbaruar arsimin e mesëm të rregullt; KF- aftësi të kufizuara fizike; A- autizëm dhe çrregullime të spektrit autik; KI- aftësi të kufizuara intelektuale; DD- dëgjim të dëmtuar

NUMRI I PJESEMARRËSVE SIPAS:					
Gjinia		Pozita profesionale			
f	m	Defektologe	Arsimtare	Pedagoge	Psikologe
10	0	6	2	1	1

**PASQYRA 11:**

Struktura e arsimtarëve dhe përfaqësuesve të shërbimit profesional – pjesëmarrës në fokus grup

**Korniza kohore**

Hulumtimi u zbatua në periudhën gusht – nëntor të vitit 2017, sipas dinamikës së mëposhtme:

- hulumtim nga zyra: tetor- nëntor;
- hulumtim me anketa: gusht- shtator;

- vizita në shkolla dhe intervista me përfaqësuesit e shkollave: tetor; dhe
- fokus grupet: tetor.

Pas përpunimit të të dhënave të grumbulluara, raporti i studimit u finalizua në fillim të janarit të vitit 2018.



## ANALIZA E KORNIZËS LIGJORE

### **Korniza dhe standardet ndërkombëtare**

Kornizën ligjore ndërkombëtare dhe standardet në fushën e arsimit gjithëpërfshirës janë përcaktuar nga: Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara<sup>7</sup> (KDKPAK), Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF)<sup>8</sup> dhe Deklarata e UNESCO-s për arsim të bazuar mbi nevojat e posaçme nga Salamanka (më tutje: Deklarata e Salamankës<sup>9</sup>). Konventat janë ratifikuar në vend, meqenëse dispozitat e tyre janë pjesë e rendit juridik të shtetit.

Këto dokumente bazohen në pikëpamjen se çdo fëmijë ka nevoja individuale. Prandaj, vetëm zbatimi i qasjes së individualizuar për arsimin mundëson që të zhvillohen maksimalisht potencialet dhe të ofrohen mundësi të barabarta arsimore për të gjithë fëmijët. Qasja e individualizuar do të thotë se sistemi arsimor ka nevojë për të përshtatur të gjithë procesin e mësimdhënies dhe të mësuarit me nevojat dhe aftësitë e secilit fëmijë. Për të marrë pjesë në mënyrë të barabartë në procesin arsimor, fëmijët me aftësi të kufizuara kanë të drejtë për mbështetje individuale.

KDKPAK në nenin 7 obligon shtetet që të sigurojnë të gjitha të drejtat e njeriut në

7 Shiko: Ibid1

8 Shiko: Konventa për të Drejtat e Fëmijës, gjendet në [https://www.unicef.org/tfyrmacedonia/CRC\\_albanian\\_language\\_version\(3\).pdf](https://www.unicef.org/tfyrmacedonia/CRC_albanian_language_version(3).pdf)

9 Shiko: Deklarata e UNESCO-s për arsim të bazuar mbi nevojat e posaçme nga Salamanka (Deklarata e Salamankës), gjendet në [https://www.unesco.de/fileadmin/medien/Dokumente/Bildung/Salamanca\\_Declaration.pdf](https://www.unesco.de/fileadmin/medien/Dokumente/Bildung/Salamanca_Declaration.pdf)

mënyrë të barabartë me të gjithë fëmijët e tjerë". Vendimmarrja duhet të bazohet në "interesin më të mirë të fëmijës". Neni 9 siguron qasje në personat me aftësi të kufizuara në mënyrë të barabartë me të tjerët", ndër të tjera, për shkollat, qasje në informacione të ndryshme, internetin dhe teknologjitë e reja të informacionit dhe komunikimit. Neni 24 i KPAK-së i referohet në mënyrë specifike arsimit, duke i detyruar shtetet "të mos përjashtojnë në bazë të aftësisë së kufizuar" fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara nga sistemi i përgjithshëm arsimor". Shtetet janë të detyruara të ofrojnë "përshtatje të arsyeshme ndaj nevojave individuale" dhe "mbështetje efektive individuale" për fëmijët me aftësi të kufizuara "brenda sistemit të arsimit të përgjithshëm". Mësimi duhet të bëhet në "gjuhët më të përshtatshme, në mënyra dhe me mjete më të përshtatshme për komunikim me çdo individ", duke përmendur, ndër të tjera, Brill dhe gjuhën e shenjave. I njëjti nen i detyron shtetet të trajtojnë dhe aftësojnë mësuesit për të ofruar mbështetje individuale për nxënësit me aftësi të kufizuara "duke përfshirë mësuesit me aftësi të kufizuara". Qasja e barabartë e personave me aftësi të kufizuara duhet të ofrohet për të gjitha nivelet e arsimit, duke përfshirë "arsimin e lartë të përgjithshëm, trajnimin profesional, arsimin e të rriturve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës". Duhet të theksohet se Neni 31 i fton shtetet palë të "mbledhin informacionin e duhur, duke përfshirë të dhënat statistikore dhe hulumtuese, në mënyrë që të sigurohet formulimi dhe zbatimi i politikave për zbatimin e kësaj Konvente".

Deklarata e Salamankës parashikon se fëmijët me aftësi të kufizuara “duhet të kenë qasje në shkolla të rregullta të cilat duhet të plotësojnë nevojat e tyre duke aplikuar qasjen pedagogjike që synon fëmijët.” Deklarata thekson se përfshirja e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në arsimin e përgjithshëm duhet të jetë rregull, ndërkaq jo përjashtim: “Një parim themelor i shkollës gjithëpërfshirëse është që të gjithë fëmijët duhet të mësojnë së bashku, kudo që të jetë e mundur, pavarësisht vështirësive dhe diversiteteve që mund të ekzistojnë. Shkollat gjithëpërfshirëse medoemos duhet t’i dallojnë dhe t’u përgjigjen nevojave të ndryshme të nxënësve të tyre, duke iu përshtatur stileve të tyre të ndryshme dhe shpejtësisë në të mësuarit dhe duke siguruar arsim cilësor për të gjithë, nëpërmjet planeve dhe programeve mësimore cilësore, përmes strukturës së posaçme të organizatës, strategjive të mësimdhënies, përdorimit të resurseve dhe përmes partneritetit me komunitetet lokale.”

Në KDF, fëmijëve me aftësi të kufizuara u është dedikuar neni 23, i cili parashikon se një fëmijë me aftësi të kufizuara intelektuale ose fizike duhet të bëjë një jetë normale dhe me dinjitet, në kushte që garantojnë dinjitetin, nxisin pavarësinë dhe lehtësojnë pjesëmarrjen aktive të fëmijës në komunitet” . I njëjti artikull njih “të drejtën” e fëmijëve me aftësi të kufizuara për “kujdes të veçantë” dhe, ndër të tjera, “qasje efektive në arsim”.

## Korniza ligjore kombëtare

Kushtetuta e RM-së e garanton të drejtën për arsim për të gjithë duke shënuar se: “Secili ka të drejtë për arsimim. Arsimimi është i arritshëm për secilin nën kushte të barabarta.”<sup>10</sup>.

Akti kryesor në fushën e arsimit të mesëm është Ligji për Arsim të Mesëm<sup>11</sup>:

Ky ligj nuk parashikon aftësinë e kufizuar si një bazë të mundshme për diskriminim (neni 3, paragrafi 3).

Neni 32 përcakton që arsimi i mesëm arrihet nëpërmjet planeve dhe programeve për, ndër të tjera, “arsimin e mesëm për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore” (paragrafi 4).

Neni 33, paragrafi 1, parashikon të drejtën e regjistrimit në një shkollë të mesme - gjimnaz, për nxënësit me kohë të plotë që kanë përfunduar arsimin fillor; Neni 34, paragrafi 1, parashikon të drejtën e regjistrimit në shkollën e mesme profesionale për nxënësit e rregullt dhe të çrregullt që kanë përfunduar arsimin fillor: “Nxënësit me nevoja të veçanta nuk përmenden aspak në dispozitat që kanë të bëjnë me regjistrimin e nxënësve në arsimin e rregullt të mesëm.

Neni 39, paragrafi 1, parashikon se hë arsimin e mesëm, nxënësit me nevoja

10 Neni 44 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonis.

11 Ligji për Arsim të Mesëm (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016 dhe 67/2017)

të veçanta arsimore edukohen sipas programeve për profesione ose profile të posaçme arsimore ose për aftësim profesional.”

Përveç kësaj, neni 40, paragrafi 1, thotë se “arsimi i mesëm për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore përfshijnë nxënësit të cilët janë të regjistruar dhe të ndarë në bazë të llojit dhe shkallës së pengesës në zhvillim.

Kur këto dy dispozita shihen së bashku, duket sikur fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara që kanë dokumentacion adekuat të aftësisë së kufizuar të tyre, janë dërguar në shkollat e mesme speciale. Nëse merret parasysh se arsimi i mesëm special u mundëson nxënësve të aftësohen vetëm për një numër të kufizuar të profesioneve, mund të konsiderohet se këto zgjidhje çojnë kah segregimi i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, duke zvogëluar mundësitë e këtyre nxënësve në të ardhmen të gjejnë punë në tregun e hapur të punës. Kështu, ka nevojë për përmirësime në dy drejtime - fëmijët me aftësi të kufizuara të regjistrohen masivisht në arsimin e rregullt, gjë që gjithashtu kërkon nevojë për program më të diferencuar arsimor, kurse nga ana tjetër është e nevojshme të modernizohen programet dhe planet mësimore në shkollat speciale.

Neni 9-c, paragrafi 1 përshkruan përmbledhjen e të dhënave që shkolla e mesme e mban për nxënësit e vet dhe siguron, ndër të tjera, detyrimin për të regjistruar nevojën e veçantë arsimore” të nxënësit. Ky artikull përcakton vetëm detyrimin e shkollave për të mbledhur të dhëna mbi aftësinë e kufizuar të nxënësve, por nuk

jep detaje se si shkollat i qasen kësaj çështjeje.

Neni 40, paragrafët 2 dhe 3 parashikojnë detyrim për të krijuar një ekip për inkluzion dhe përgatitje të planeve individuale të arsimit, por vetëm për nxënësit e regjistruar në shkollat e mesme speciale (d.m.th. “për nxënësit e paragrafit 1”). Ky është një lëshim serioz në tekstin e ligjit, pasi që neni 40 paragrafi 1, siç u tha më lart, i referohet “arsimit të mesëm për nxënësit me nevoja të veçanta”. Në të njëjtin nen thuhet se “mënyra e regjistrimit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në shkollat e mesme përcaktohet nga Ministri, me propozimin e Byrosë për Zhvillimin e Arsimit”, por kjo nuk përcakton plotësisht procedurën e regjistrimit.

Zgjidhje segreguese është dhënë gjithashtu në aspektin e transportit. Gjegjësisht, neni 41, paragrafi 5 i Ligjit për Arsim të Mesëm përcakton se nxënësit me nevoja të veçanta arsimore dhe shoqëruesi i tij kanë të drejtë të transportit të lirë pavarësisht nga distanca e vendbanimit të tyre nga shkolla e mesme”. Ajo që e kufizon këtë të drejtë vetëm për nxënësit e përfshirë në arsimin e mesëm për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore janë: neni 2, paragrafi 3 i të njëjtit ligj, i cili përcakton se shkollat e mesme publike janë themeluar për “kategori të caktuara të nxënësve për të cilat shteti ka një interes të veçantë, domethënë siç thuhet në këtë nen: “Shkollat e mesme shtetërore janë themeluar vetëm për realizimin e planeve dhe programeve për arsimin e mesëm të kategorive të caktuara nxënësish për të cilat shteti ka një interes të veçantë”. Përveç kësaj, neni 111 i të njëjtit ligj i

përfshin me emër shkollat speciale në kategorinë e shkollave të mesme publike.

Neni 59, paragrafi 1 përcakton që defektologu mund të jetë pjesë e “bashkëpunëtorëve profesional” në shkollat e mesme që kryejnë “punën edukativo-arsimore”. Udhëzimet e detajuara për kompetencat e defektologut në arsimin e mesëm janë dhënë në Rregulloren për kompetencat themelore profesionale sipas fushave të ndryshme të bashkëpunëtorit profesional në shkollat fillore dhe të mesme (njësoj si ato të defektologëve në shkollat fillore). Rregullorja u përket kompetencave dhe në mënyrë indirekte tregon rolin e defektologut në procesin arsimor. Përveç mundësisë jodetyruese, ku në vend të domosdoshmërisë përcaktohet se mësuesi i posaçëm mund të jetë pjesë e shërbimit profesional, mungon edhe një akt me udhëzime për rolin dhe kompetencat e defektologut.

Në Ligjin për Librat Shkollore për Arsim Fillor dhe të Mesëm<sup>12</sup> në nenin 2 theksohet se libri shkollor është mjet mësimor parësor dhe burim njohurish për arritjen e qëllimeve arsimore të përcaktuara në plan-programin për arsimin fillor dhe të mesëm. Asnjë nga nenet në ligj nuk parashikon që tekstet duhet të bëhen në një format që do të jetë në dispozicion për të gjithë nxënësit, duke përfshirë tekstet elektronike në një format të aksesueshëm, tekstet në Brill, tekste që janë të lehtë për t'i lexuar etj. Në Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin

Profesional<sup>13</sup> asnjë nga nenet nuk ka theksuar se edhe nxënësit me aftësi të kufizuara kanë të drejtën e arsimit dhe aftësimin profesional ose që duhet të ndërmerren përshtatjet lidhur me aksesin fizik të objekteve shkollore, përgatitje të planeve individuale për arsimin dhe aftësimin profesional, qasje e materialeve mësimore ose pajisjeve të personalizuar për mbrojtje në punë.

Për shembull, në nenin 13 për arsimin dhe aftësimin profesional, i cili i përket verifikimit të punëdhënësve të trajnimit praktik, në paragrafin 1 nuk është theksuar se plotësimi i kushteve për sa i përket hapësirës, pajisjeve dhe personelit adekuat duhet të marrin në konsideratë edhe nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara.

Neni 13 nuk parashikon qasjen në institucionet e arsimit profesional, si kusht për verifikim. Neni 18 ku ofrohet përshkrimi i llojeve, gjatësisë dhe niveleve të kualifikimit në arsimin profesional, nuk përcakton se edhe nxënësit me aftësi të kufizuara mund të fitojnë ndonjë lloj arsimit profesional, si dhe duhet të kenë të drejtën e planeve individuale të arsimit me qëllim që të fitojnë arsimin e nevojshëm.

12 Ligji për Librat shkollore për Arsim Fillor dhe të Mesëm (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 98/2008, 99/2009, 83/2010, 36/2011, 135/2011, 46/2012, 24/2013, 120/2013, 29/2014, 146/2015, 217/2015 dhe 30/2016)

13 Ligj për Arsim dhe Trajnim Profesional (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 71/2006, 117/2008, 148/2009, 17/2011, 24/2013, 137/2013, 41/2014, 145/2015 dhe 55/2016).

Ligji për Standardin e Nxënësve<sup>14</sup>, veçanërisht në nenet që kanë të bëjnë me konviktet, përshtypja është se bëhet fjalë për konvikte për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore dhe konvikte për nxënësit e tjerë. Nuk ka dispozita që specifikojnë se konviktet duhet të kenë qasje të përshtatur, të ketë të paktën një ose dy dhoma të adaptuara, ku mund të qëndrojnë nxënësit me aftësi të kufizuara, gjithashtu edhe tualet të përshtatura.

Në nenin 24 theksohet se numri i nxënësve në një grup edukativ për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore është tetë, kurse në raste me aftësi të kufizuara të shumëfishta deri në gjashtë nxënës. Kjo përsëri tregon se bëhet fjalë për grup të segreguar ose konvikt vetëm për nxënësit me aftësi të kufizuara.

Neni 33 i cili i përket stafit në konvikte përmban gjithashtu një dispozitë që tregon se bëhet fjalë për konvikt vetëm për nxënësit me aftësi të kufizuara.

Ligji për Mësuesit në Shkollat Filllore dhe të Mesme<sup>15</sup> nuk ka dispozita konkrete të cilat specifikojnë se mësuesit duhet t'u përgjigjen nevojave të nxënësve me aftësi të kufizuara. Për shembull, në nenin 13, detyrat e mësuesve nuk përfshijnë zhvillimin e një plani individual të arsimit si një nga detyrat e tyre të punës.

Në fushën e kompetencave themelore profesionale të mësuesve në nenin 18 thuhet se përfshirja sociale dhe arsimore është një nga fushat në të cilat mësuesit duhet të posedojnë vlerat profesionale, njohuri profesionale dhe të kuptuarit, si dhe aftësitë dhe shkathtësitë profesionale.

<sup>14</sup> Ligj për Standardin e Nxënësve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 52/2005, 117/2008, 17/2011, 135/2011, 15/2013, 41/2014, 146/2015 dhe 30/2016)


<sup>15</sup> Ligji për Mësuesit në Shkollat Filllore dhe të Mesme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 10/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016 dhe 67/2017)



## GJETJET KRYESORE NGA HULUMTIMI NË TERREN

### Përfaqësimi i nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin e mesëm të rregullt

Në vitin e kaluar dhe aktual shkollor, nga gjithsej 92 shkollarrët që kanë dorëzuar përgjigje të pyetësorit, 52 (ose 56,5%) kanë paraqitur se kanë nxënës me nevoja të veçanta arsimore. Në këto shkolla mësimdhënie ndjekin 246 nxënës me nevoja të veçanta arsimore.



■ Shkolla me nxënës me NVA

■ Shkolla pa nxënës me NVA

#### PASQYRA 12:


#### Shkolla me dhe pa nxënës me nevoja të veçanta arsimore

Në dy vitet e fundit shkollore, në secilën prej shkollave, mesatarisht ka 2.79 nxënës me nevoja të veçanta arsimore, ose 0.4%. Nëse marrim parasysh vetëm shkollat që kanë informuar për nxënësit me nevoja të veçanta mësimore, mesatarja është 4.94 nxënës për shkollë ose 0.65%.

Analiza e kombinuar e të dhënave tregon se ekziston një dallim i theksuar midis përqindjes së nxënësve me aftësi të kufizuara në Rajonin e Shkupit në krahasim me rajonet e tjera: Në Rajonin e Shkupit, përqindja e nxënësve me aftësi të kufizuar është 0.22; në të gjitha rajonet e tjera 0.50 përqind. Hulumtimi nuk është dizajnuar që të përcaktojë se nga rrjedh ky dallim, por një nga supozimet e mundshme është se ai bazohet në faktin se ka më pak alternativa të disponueshme jashtë Shkupit.

Në vitin e kaluar dhe aktual shkollor, përqindja e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në rajonin e Shkupit si dhe në rajone të tjera në vend është identik.


#### 2016-2017/2017-2018



Shkolla nga Shkupi pa nxënës me aftësi të kufizuara/Shkolla nga Shkupi me nxënës me aftësi të kufizuara

Shkolla të tjera pa nxënës me aftësi të kufizuara/Shkolla të tjera me nxënës me aftësi të kufizuara – da se vnesat

#### 2016-2017/2017-2018



Shkolla nga Shkupi pa nxënës me aftësi të kufizuara/Shkolla nga Shkupi me nxënës me aftësi të kufizuara


Shkolla të tjera pa nxënës me aftësi të kufizuara/Shkolla të tjera me nxënës me aftësi të kufizuara – da se vnesat

#### PASQYRA 13:

#### Përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në Rajonin e Shkupit dhe në rajonet e tjera në vend



Analiza ka treguar se shumica, ose më saktësisht 85 shkolla që i janë përgjigjur pyetësorit, nuk kanë qenë në situata në tri vitet e fundit që të "jënë të detyruar të refuzojnë" ndonjë nxënës me aftësi të kufizuara:



#### PASQYRA 14:

Përgjigjet ndaj pyetjes "A ka ndodhur në tri vitet e fundit në shkollën tuaj që shkolla juaj të mos ketë mundësi të pranojë ndonjë nxënës me aftësi të kufizuara?"

Shkolla që ka qenë në një situatë të tillë ilustron faktin se shkollat nuk udhëhiquan nga mënyra të përcaktuara me ligj për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Sistemi nuk ofron zgjidhje për procedurën për pranimin ose refuzimin e një nxënësi me nevoja të veçanta arsimore. Zgjidhjet janë individuale dhe zakonisht bëhet fjalë për improvizim. Deklarata e mëposhtme ilustron të njëjtën gjë: *"Për shkak të shkallës së aftësisë së kufizuar, nxënësja erdhi nga një klasë speciale e shkollës fillore. I dërguam prindërit t'i drejtohen udhëheqësit të departamentit të arsimit në Komunën e Koçanit dhe inspektorit për arsim, të cilët më tutje i kanë dërguar në SHMS Iskra-Shtip."*

Edhe pse, 92% apo 85 shkolla në tri vitet e fundit nuk kanë refuzuar ndonjë nxënës me aftësi të kufizuara, ka dallime individuale në të kuptuarit e konceptit të përfshirjes, e cila u konfirmua gjatë vizitave në terren dhe fokus grupeve.

Gjatë vizitave në terren kemi hasur individë, por edhe klimë shkolllore dhe politika që konsiderojnë se nxënësit me aftësi të kufizuara duhet të arsimohen në klasa të veçanta ose në shkolla speciale. Një mësues tha: *"Falë Zotit ne nuk kemi nxënës të tillë, Zoti na ruajt të mos kemi, ata nuk janë për një shkollë elite siç është shkolla jonë ... Gruaja ime punon me 'mentalët' në shkollën speciale, unë e di se çfarë janë këta fëmijë dhe sa mund."* Kjo deklaratë tregon për një qëndrim tepër mospranues ndaj nxënësve me aftësi të kufizuara. Thjesht emërtimi dhe përdorimi i terminologjisë "mental" i referohet mosrespektimit të dinjitetit dhe marrjes së një qëndrimi që nuk duhet të jetë i pranishëm në asnjë segment të shoqërisë, sidomos jo kur punohet me nxënës.


Shkollat thonë se në disa mjedise ka refuzim kolektiv apo turp dhe mendim se shkollat e rregullta nuk janë mjedis i përshtatshëm për nxënësit me aftësi të kufizuara. *"Në mjedisin tonë, vetë prindërit konsiderojnë se fëmijët e tyre me aftësi të kufizuara duhet të shkojnë në shkolla speciale. Këtu, shumica e prindërve i mbajnë fëmijët në shtëpi, kanë turp t'i nxjerrin jashtë dhe nuk i pranojnë problemet që kanë"*, thotë një mësues i shkollës së mesme nga brendësia e vendit. Ekzistenca e një qëndrimi të përbashkët për mospranim të nxënësve me aftësi të kufizuara i ka rrënjët më

thellë dhe pasqyron mentalitetin dhe qëndrimin që është lidhur me ndonjë komunitet lokal. Kjo nuk i përfshin vetëm palët e përfshira në arsim, por është e pranishme edhe te prindërit, popullsia lokale, nxënësit me aftësi të kufizuara, por edhe te të gjithë nxënësit e tjerë që nga mosha e re. Arsimi në atë frymë çon në ndarje të mëtejshme.

është e mënyrës së regjistrimit dhe përzgjedhjes së shkollës së mesme u parashtrua edhe në fokus grupet me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe prindërit e nxënësve me aftësi të kufizuara të përfshirë në arsimin e rregullt të mesëm. Të dhënat e marra tregojnë se nxënësit me aftësi të kufizuara zgjedhin shkollën e mesme me ndihmën e prindërve të tyre ose e shfrytëzojnë mundësinë e vetme që u ofrohet atyre, d.m.th. ata nuk kishin zgjidhje. Një nxënës thotë: *“Unë jetoj në një fshat pranë Vallandovës. Ka vetëm një shkollë të mesme në qytetin tonë. Për shkak të situatës dhe kushteve të mia specifike, duhet të jem pranë shtëpisë sime dhe prindërve të mi. Unë nuk kisha ndonjë*

*zgjedhje kur u regjistrova në shkollën e mesme, më duhej të regjistrohesha në shkollën e vetme që ekziston në vendin tonë.”* Disa nga nxënësit nuk morën pjesë në regjistrimin në shkollë. Prindërit e tyre dorëzuan dokumentet e nevojshme. Prindërit thonë se marrja e një vendimi përfundimtar është një detyrë e vështirë për ta dhe ata gjithashtu mbështeten në përkrahjen e profesionistëve që kanë punuar më parë me fëmijët e tyre. Sipas tyre, ajo që do të sillte paqen është afërsia e shkollës, sepse në çdo moment ata mund t’i ndihmojnë fëmijët e tyre nëse kanë nevojë për ta.

Kjo veçanërisht u përket nxënësve që jetojnë në vendet më të vogla në shtet, si dhe për nxënësit që kanë përfunduar një shkollë fillore speciale. Zgjedhja që ofrohet nuk është gjithmonë e përshtatshme për interesat, mundësitë dhe aftësitë e tyre. Në këtë mënyrë, është e diskutueshme, së pari, për gatishmërinë e nxënësve për një profesion të përshtatshëm pas përfundimit të arsimit të tyre, por edhe mundësitë e tyre për punësim me diplomën për arsimin e mesëm të kompletuar.



#### PASQYRA 15:

Përgjigjet e pyetjes “Në ç’ mënyrë i identifikon shkolla juaj nxënësit me aftësi të kufizuara?”

Procesi i zbulimit, identifikimit dhe regjistrimit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore është i vështirësuar për shkak të shërbimeve të pakomletuara profesionale, dhe rezistenca që ekziston te disa prindër të pranojnë paaftësinë e fëmijës së tyre dhe të reagojnë në mënyrë të përshtatshme. Këto të dhëna konfirmohen edhe nga vizitat në terren dhe nga fokus grupet. Shkollat thonë se gjatë përcaktimit të nevojave të veçanta arsimore te nxënësit, përdorin disa modele: Një pjesë e prindërve paraqesin një gjetje dhe një opinion mbi aftësinë e kufizuar të fëmijës kur regjistrohen. Prindërit e tjerë gojariht informojnë shkollën për gjendjen dhe nevojat e fëmijës së tyre. Për disa fëmijë që kanë vështirësi, arsimtarët raportojnë te shërbimi profesional, ose te defektologu nëse shkolla ka një defektolog. Defektologu ose ndonjë anëtar tjetër i shërbimit profesional flet me fëmijën, e vëzhgon / ndjek dhe pastaj, së bashku me arsimtarin, bisedon me prindërit. Gjatë vizitave në terren, vetëm një shkollë prej 16 shkollave gjithsej, paraqiti procedura të brendshme në bazë të të cilave përcakton dhe zbulon nevojat e posaçme arsimore të nxënësit. Vlerësimi, i kryer nga shërbimi profesional në bashkëpunim me mësuesit, bazohet në aftësitë funksionale të nxënësve dhe ofron informata të detajuara dhe të gjera mbi aftësitë dhe vështirësitë e nxënësve. Vizitat në terren e konfirmojnë këtë informacion. Shkollat theksojnë se një nga sfidat e hasura në procesin e përfshirjes në arsimin e mesëm është identifikimi dhe regjistrimi i nevojave të veçanta të nxënësit. Përveç arsyeve të mësipërme, tek ata krijohet konfuzion edhe mungesa e një procedure të caktuar të identifikimit dhe raportimit të

nxënësve me nevoja të veçanta arsimore. Domethënë, sipas inspektorëve arsimorë që vizitojnë shkollat, si nxënës me nevoja të veçanta arsimore raportohen vetëm nxënësit të cilët kanë një mendim mjekësor ose mendim dhe vlerësim nga ndonjë institucion përkatës. Shkollat kanë vështirësi t'i bindin prindërit që të marrin mendim mjekësor. Ligji nuk i obligon prindërit të dorëzojnë mendim mjekësor. Prandaj, ka dallime në identifikimin dhe regjistrimin e numrit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, ndërmjet shkollave.

Mënyrat dhe qasjet e ndryshme në identifikimin e numrit të nxënësve me aftësi të kufizuara çojnë në dallime dhe mospërputhje në përgjigjet e dhëna në pyetësorin edhe gjatë vizitave në terren. Devijimet janë të bazuara në dy arsye të rëndësishme: në pyetësor raportohet për nxënësit për të cilët shkolla ka një dokument përkatës që e konfirmon nevojën e posaçme arsimore dhe janë raportuar nxënësit për të cilët, në kornizën kohore brenda të cilës është bërë ky studim, ka siguri për disa nevoja të veçanta arsimore. Në vizitat në terren në gjashtë shkolla, nga gjithsej 16, ka pasur dallime në numrin e raportuar. Dallimet janë pasojë e paraqitjes së dokumentacionit të ri ose identifikimit dhe zbulimit të nxënësve nga shërbimi profesional i shkollës, më shpesh për nxënësit që janë në vitin e parë. Shkollat i raportuan edhe ata nxënës që nuk kanë një dokument që konfirmon nevojën e veçantë arsimore, domethënë nxënësit të cilët vlerësohen nga shërbimi profesional dhe mësuesit. Ata theksuan se pamundësia për të detyruar prindin të sigurojë mendim mjekësor, e komplikon

shumë punën dhe nuk i lejon arsimtarët të punojnë sipas planeve individuale të arsimit. Vështirësitë e nxënësve në situata të tilla bëhen më të dukshme. Kështu arrijmë një zbulim shumë të rëndësishëm i cili konfirmon se identifikimi dhe vlerësimi i nxënësve shumë shpesh varet vetëm nga “ekspertiza” e mësimeve dhe e shërbimit profesional, të cilët në shumicën e rasteve nuk janë të trajnuar sa duhet për zbatimin e këtyre proceseve. Mungesa e njohurive dhe mjeteve për vlerësim e çon procesin në nivel të improvizimit dhe ka ndikim edhe mbi hapat e mëtejshëm, siç janë përshtatja e hapësirës, përshtatja e planeve dhe programeve mësimore dhe zbatimi i plotë i procesit arsimor. Në fakt, mungojnë njohuritë dhe kushtet për zbatimin e procesit kryesor nga i cili planifikohen të gjitha aktivitetet e tjera më tutje.

Në anketën, 43.5% prej të anketuarve deklaruan se nuk kanë nxënës me nevoja të veçanta arsimore. Gjatë vizitave në terren, ka pasur edhe shkolla që nuk kanë raportuar fare nxënës me nevoja të veçanta arsimore. Ata dhanë të njëjtin informacion përsëri. Arsytet për këtë janë të ndryshme. Një nga shkollat në vitin e kaluar ka pranuar një nxënës me aftësi të kufizuara, por nxënësit nuk e pranuan dhe vetëm një muaj më vonë nxënësi ishte çregjistruar nga shkolla. Afër kësaj shkolle ka shkollë tjetër me klasa speciale dhe transportim të organizuar falas. Mospranimi i nxënësit nga nxënësit e tjerë si dhe mundësia për transportin e organizuar falas, janë arsytet për këtë vendim, edhe pse ishte vlerësuar se mundësitë dhe dëshira e nxënësit ishin të mësojë në arsim të rregullt. Shkollat e

tjera janë shkolla që kanë kritere të larta për regjistrimin e nxënësve apo shkolla me drejtime që nuk janë mjaft tërheqëse dhe të përshtatura për mundësitë e nxënësve me aftësi të kufizuara. Një nga mësuesit gjatë vizitave në terren tha: **“Në shkollën tonë nuk kemi nxënës me aftësi të kufizuara. Kriteret për të hyrë në shkollën tonë janë shumë të larta dhe nuk pritet që ndonjë fëmijë me aftësi të kufizuara të regjistrohet dhe të kalojë përzgjedhjen”**. Kriteret më të larta lidhen me një renditje më të lartë të pikëve të arritura nëpërmjet suksesit të arritur në arsimin fillor dhe pjesëmarrjen në gara të ndryshme. Gjatë bisedës me mësuesin kemi marrë informacione të rëndësishme: përkatësisht deklarata e mësuesit se nxënësit me aftësi të kufizuara nuk mund të plotësojnë kriteret e larta, na tregon se një nxënës me aftësi të kufizuara perceptohet si nxënës me nivel të ulët të aftësisë intelektuale. Në bisedën me këtë arsimtar, ekipi hulumtues shpjegoi se nxënësit kanë aftësi të ndryshme që nuk lidhen me aftësinë e kufizuara, por nga arsimtari morëm një reagim që mund të interpretohet si skepticizëm.

Ky fenomen ilustron mosbesimin në pikat e forta të nxënësve me aftësi të kufizuara dhe krijimin e një imazhi të bazuar në përgjithësim se të gjithë nxënësit me aftësi të kufizuara kanë pengesa të mëdha në zhvillimin intelektual dhe se duhet të arsimohen në shkolla speciale.

Në tentimin për krahasim sipas kritereve të ndryshme (lloji i arsimit, rajoni, gjuha e mësimeve) dhe të dhënat e marra nga sondazhi të vihen në korrelacion, nuk u arritën devijime të mëdha. Mendimet, pritjet, gatishmëria dhe

qëndrimet e shkollave janë të ngjashme në të gjitha shkollat. Megjithatë, dallimet domethënëse u shfaqën gjatë vizitave në terren dhe në fokus grupet, nga të cilat janë marrë të dhëna cilësore, të cilat janë të rëndësishme për pasurimin e pamjes së përgjithshme në lidhje me inkluzionin. Të dhënat cilësore na lejojnë që t'i vendosim numrat në kontekst.

Edhe pse të dhënat cilësore nuk janë reprezentuese për shkak të numrit të vogël të shkollave të vizituara dhe të fokus grupeve, gjithsesi mund të interpretohen si një tregues për nevojën për të zbatuar një hulumtim më të thellë që do të përqendrohet kryesisht në gjenerimin e të dhënave cilësore. Duke pasur parasysh kontrastin midis përgjigjeve të pyetësorit dhe pikëpamjet e ndara gjatë intervistave dhe fokus grupeve, mund të nxirret përfundimi se për pamje më të plotë dhe realiste në lidhje me këto çështje, është e nevojshme që të kemi në dispozicion edhe të dhëna në lidhje me qëndrimet dhe paragjykimet.


Pyetësorit të anketës, shkollat i kanë dhënë përgjigje të ngjashme në drejtim të hapjes dhe gjithëpërfshirjes së tyre. Gjatë vizitave në terren, një anëtar i shërbimeve profesionale tha se **“Mësuesit tanë janë humanë”**. Humanizmi është pasqyruar nëpërmjet dëshirës dhe vullnetit të tyre që në shkollë dhe në klasa të ketë nxënës me aftësi të kufizuara. Vënia e kësaj çështjeje në nivel të vullnetit dhe humanizmit e jo në nivel të një të drejte,

na tregon se bëhet fjalë për një model mjekësor të trajtimit të çështjes dhe hap dilema të reja. Imazhi i gjithëpërfshirjes, sipas të dhënave nga vizitat në terren dhe fokus grupet, bazohet mbi nxënësit e regjistruar në shkollë. Shkolla me nxënës me aftësi të kufizuara është një shkollë gjithëpërfshirëse. Një nga burimet e mundshme të mendimit të tillë është mungesa e standardeve për përfshirje në shkollat, që më tutje kontribuon për krijim të një imazhi të gabuar dhe pritjeve të ulëta të shkollat.

## GJITHËPËRFSHIRJA E SHKOLLAVE

Shkollat nuk i plotësojnë kushtet e nevojshme për qasje fizike. Një pjesë e shkollave i kanë bërë adaptimet e nevojshme sipas nevojave të nxënësve

me aftësi të kufizuar, por mungesa e qasjes vazhdon ta vështirësojë inkluzionin e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuar:



### **PASQYRA 16:**

Përgjigjet e pyetjes “Çfarë përshtatje janë bërë për të siguruar aksesueshmëri fizike në shkollën tuaj?”

Gjatë vizitave në terren, kemi vërejtur se kur bëhet fjalë për aksesueshmërinë, hyrja e shkollave është e arritshme, por jo pjesa e brendshme. Megjithatë ka rampa aksesuese në hyrjen kryesore të shkollave, ka raste kur rampat nuk janë të përdorshme për nxënësit sepse nuk i plotësojnë dhe respektojnë standardet për aksesueshmëri. Përveç kësaj, nxënësit që përdorin karrocë kanë nevojë për mbështetje që zakonisht ofrohet nga prindërit e tyre. Këtë e konfirmuan edhe prindërit dhe nxënësit që morën pjesë


në fokus grupet. Një nxënëse që përdor karrocë po thotë: **“Rampa që ekziston në shkollën time është e pjerrët, unë nuk mund të ngjitem me karrocën time vet”.**

Aksesueshmëria e tualeteve në shumë shkolla si koncept është mjaft i panjohur. Nga vizitat në terren, një nga shkollat tregoi se në katin e parë kishte një tualet “të aksesueshëm”, i cili ishte përshtatur për një mësuese që ka vështirësi me lëvizjen. Përshtatja përbëhet nga montimi i një oturaku të ri në një prej tualeteve, kurse tualetet e tjera mbeten të vjetra.

Mungesa e tualetit të aksesueshëm e bën të vështirë që nxënësit të qëndrojnë në shkollë dhe e imponon nevojën që edhe prindërit të mbeten në shkollë, siç kanë theksuar vetë prindërit dhe nxënësit gjatë fokus grupeve. Por sa e vështirë është kjo për nxënësit, ilustrimin më të mirë e jep deklarata e mëposhtme e një nxënësi me aftësi të kufizuara: ***“Gjëja më e vështirë për mua në shkollën time është se nuk mund të shkojnë në tualet, nuk është i aksesueshëm. E njëjta gjë ishte edhe në shkollën time filllore, por ne këmbëngulëm dhe ata bënë një tualet të aksesueshëm. Dhe këtu bëjmë këmbëngulje. Unë duhet të mbaj “parandalim” për të qëndruar në të gjitha orët. Kur kam nevojë urgjente, më ndihmon nëna ime”.***

Përshtatja më e shpeshtë kur është fjala për aksesin fizik, është realizimi i të gjitha orëve mësimore në një klasë të vendosur në katin përdhes. Ka raste kur nxënësit nuk ishin në gjendje të ndjekin disa prej orëve. ***“Unë nuk mund të shkoj në orët e TIK-ut”***, tha një nxënëse me aftësi të kufizuara fizike gjatë një grupi të fokusit.

Situata është edhe më e pafavorshme kur bëhet fjalë për disponueshmërinë e mjeteve mësimore pedagogjike-didaktike dhe ndihmëse (të përshtatura). Përkatësisht, shumica e shkollave ose 74 shkolla u përgjigjën se nuk kanë pajisje që do ta lehtësonte përfshirjen aktive të nxënësve me aftësi të kufizuara:



#### **PASQYRA 17:**

Përgjigjet e pyetjes “A ka në shkollën tuaj mjete pedagogjike-didaktike (të përshtatura) dhe mjete ndihmëse?”

13% e shkollave deklaruan se kanë materiale të përshtatura didaktike. Më shpesh, këto janë shkolla në të cilat defektologët përgatisin materiale të përshtatura për punë individuale me nxënësit, ose shkolla me qendra për karrierë në të cilat ka teknologji të përshtatur informative ndihmëse.

Gjatë zbatimit të fokus grupeve, mësuesit thonë: ***“Ne nuk kemi asgjë, nuk kemi resurse. Te ne mësimdhënia realizohet në kabinete të ndryshme, dhe ndërtesa ka dy kate dhe nuk ka ashensor, për disa nxënës lëvizja është problem, ata mezi arrijnë të përdorin pajisjet dhe mjetet vizuale që janë për të gjithë nxënësit ...”***


***“Te ne, në punën praktike në disa prej drejtimeve shkollore / profesione të caktuara (p.sh. zdrukthëtari) po përdoren makina, disa janë të rrezikshme. Unë nuk e di nëse ato mund të përshtaten, duhet të jeni shumë të kujdesshëm duke punuar me to sepse përndryshe mund***

*të lëndoheni. Ose të lëndoni dikë tjetër. Nuk kemi çfarë të bëjmë këtu, thjesht përpiqemi t'i këshillojmë prindërit që të zgjedhin një profesion/ drejtim tjetër për fëmijën e tyre. Dhe kështu bëjnë, as ata nuk duan që fëmija të lëndohet”,* thotë një mësues nga një shkollë e mesme profesionale.

Vështirësia që doli nga fokus grupet është fakti se mësuesit dhe shërbimet profesionale nuk dinë se çfarë resurse po ekzistojnë që mund t'i marrin dhe t'i përdorin për nxënësit me aftësi të kufizuara. Kjo është veçanërisht e dukshme në shkollat e mesme profesionale. Një mësues thotë: *“Unë ju thashë, ne kemi nevojë për trajnim, nuk dimë se çfarë lloj mjedesh ka për ata nxënës, çfarë mund të përdorim ... Në ato lista që na jep kompania, nuk më kujtohet emri i kompanisë, që ofron mjete ndihmëse, nuk ofrohen mjete të këtitilla.”*

Në pyetësorin e anketës, shkollat thonë se nga materialet shtesë të mësimdhënies ata kanë mjete ndihmëse që janë përgatitur sipas metodologjisë Montesori, shkollat profesionale thonë se kanë makina dhe mjete të përshtatura tekstile. Disa nga shkollat i numërojnë smart-tabelat dhe flipçart-tabelat në listën e materialeve didaktike.

Në gjendje pak më e mirë është posedimi i teknologjisë ndihmëse që shkollat kanë:



### ПРИКАЗ 18:

Përgjigjet e pyetjes “A ka në shkollën tuaj pajisje informatike-ndihmëse (tastiera të zgjeruara, trakboll, leva (xhojstik), klikim i ndarë, ekran me prekje etj.)?”

24% e shkollave të anketuara thanë se përdorin teknologji ndihmëse si mbështetje gjatë punës në qendrat për karrierë pranë shkollave. Pajisja është dhuruar nga projektit i USAID-it YES Network në bashkëpunim me Shoqatën për teknologji ndihmëse “Hapni dritaret”. Shpjegime të tjera, të paraqitura nga 22 shkolla, përfshijnë një sërë teknologjish ndihmëse: trakball, leva (xhojstik), klikime të ndara dhe tastiera të zgjeruara.

Gjatë vizitave në terren, ekipi i “Hapni dritaret” zbuloi se ka teknologji ndihmëse në shkolla, por nuk ka gjetur shembuj ku përdoret në mësimdhënie. Disa nga përfaqësuesit e intervistuar nuk ishin të njohur me mënyrën e përdorimit dhe me përfitimet e ofruara nga teknologjia ndihmëse. Përfaqësuesit e shkollave të mesme morën pjesë në trajnime, por informacioni nuk arriti të të gjithë të punësuarit, domethënë nuk ishin të mbuluar të gjithë nga diseminimi i trajnimit. Përsëri konfirmohet gjetja



se shkollat po ndërmarrin hapa për të përmirësuar inkluzionin, por ato nuk i zbatojnë plotësisht hapat. Ekzistenca e teknologjisë ndihmëse në shkollat ku nuk përdoret në punën me nxënësit me aftësi të kufizuara nuk shkon në favor të inkluzionit dhe nuk e lehtëson procesin edukativo-arsimor të nxënësve.

Sipas përgjigjeve të pyetësorit, në shumicën e shkollave ku ka nxënës me aftësi të kufizuara, 238 apo 97% e shkollave janë formuar ekipe inkluzive. Megjithatë, vizita në terren dhe përvojat e përbashkëta të dhëna në fokus grupet treguan se në disa shkolla, edhe pse ka ekipe inkluzive, ata nuk e përmbushin gjithmonë rolin e tyre. Ka raste ku ata nuk kanë takime të rregullta dhe nuk punojnë në detyrat që i kanë si qëllim. Ata takohen vetëm kur ka nevojë dhe më shpesh diskutojnë për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore kur kanë këshilla mësimore në nivel të shkollës. Roli i tyre ngatërrohet me rolin e shërbimeve profesionale në shkollat. Edhe pse në përgjigjet e pyetësorit vërehet trend pozitiv i inkluzionit, në përgjigjet e detajuara shkollat kanë deklaruar se nuk kanë formuar ekip inkluziv për shkak të mosgatishmërisë së shërbimit profesional. Kjo ilustron me përgjigjet në vijim: *“Shkolla jonë nuk ka ndjekur trajnime për të punë me nxënësit me aftësi të kufizuara”; “Në shkollën tonë nuk është formuar ekipi inkluziv për shkak se prindërit nuk dorëzojnë mendim mjekësor, kurse shërbimi profesional dhe mësuesit nuk kanë trajnim të mjaftueshëm për të identifikuar nxënësit me aftësi të kufizuara, dhe nuk kemi defektolog.”*

Përgjigjet nga anketa theksojnë se detyra e këtyre ekipeve është zbulimi, identifikimi dhe përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara, bashkëpunimi me prindërit, me mësuesit dhe mbështetja gjatë zhvillimit të një plani individual të arsimit (në tekstin e mëtejshëm PIA) dhe strategjitë më të lehta për përfshirjen e nxënësve në mësimdhënien, organizimin dhe mbajtjen e trajnimeve të brendshme me mësuesit, ose punën e drejtpërdrejtë me nxënësit.

Ka edhe 8 shkolla që, edhe pse kanë nxënës me aftësi të kufizuara, ende nuk kanë formuar një ekip inkluziv.

Arsyet për të i gjejnë në informimin e pamjaftueshëm, mungesa e trajnimeve në këtë temë, si dhe mungesën e dokumentacionit nga prindërit me qëllim konfirmohet se shkolla ka nxënës me aftësi të kufizuara si një parakusht për krijim të një ekipi inkluziv.

Gjetjet mund të ilustron nëpërmjet këtyre deklaratave:


*“Ekipi i identifikon nxënësit me nivel të lartë të marginalizimit (psikofizik, emocional, social, arsimor), përgatit një strategji operative për ekipin inkluziv, punon dhe siguron mbështetje për mësuesit, nxënësit dhe prindërit, në mënyrë të vazhdueshme duke analizuar procesin e punës, përcakton ndryshimet në gjendjen psikofizike, emocionale, sociale dhe arsimore të nxënësve, punon sipas programit vjetor.”*

*“Detyrat kryesore të ekipit janë: identifikimi i nxënësit me nevoja të veçanta arsimore dhe të nevojave të tyre specifike, krijimi i kushteve për realizim të suksesshëm, avancim i kompetencave të mësuesve për të punuar me këta*

*nxënës etj. Por mbi të gjitha, gjëja më e rëndësishme është që të krijojmë një mjedis pozitiv gjithëpërfshirës, përmes aktiviteteve të ndryshme këshilluese dhe edukative.”*

*“Ekipi inkluziv në shkollën tonë përpiqet që mësimdhënia t’u përshtatet nevojave zhvilluese, të përbashkëta dhe individuale të nxënësve, të zhvillojë, mbështesë dhe të promovojë klimë inkluzive, ku çdo mësues do të respektohet, çdo prind do të përfaqësohet dhe çdo nxënës do të mirëpritet.”*

Sipas përgjigjeve të paraqitura në anketën, mbi 60% të shkollave nuk kanë defektolog në kuadër të shërbimit profesional. Në shkollat ku ka defektolog, më shpesh ai punon me kohë të plotë pune dhe vetëm dy shkolla kanë një defektologë që e ndajnë me shkolla të tjera. Kjo formë nënkupton përdorimin e të njëjtit defektolog si një bashkëpunëtor në disa shkolla. Në rast të tillë, njëra prej shkollave e ka rolin të shkolle amë. Ilustrimi i mëposhtëm tregon gjendjen e raportuar nëpërmjet anketës:



#### **PASQYRA 19:**

Përgjigjet e pyetjes “A ka defektolog në shërbimin Tuaj profesional të shkollës?”

Nga vizitat në terren dhe gjatë fokus grupeve në shkollat ku ka të punësuar defektologë, ata vetë deklarojnë se tërë puna me nxënësit me aftësi të kufizuara u është dhënë atyre. Sipas tyre, arsimtarët

konsiderojnë se rolin kryesor për inkluzion në shkollë e ka defektologu dhe ai duhet të punojë në mënyrë individuale me nxënësit me nevoja arsimore të veçanta. Defektologët konsiderojnë se roli i tyre


duhet të jetë në drejtim të mbështetjes, të ketë rolin këshillëdhënës me arsimtarin, në drejtim të vlerësimit nevojave të nxënësit në bashkëpunim me arsimtarin dhe në drejtim të ndërtimit të klimës inkluzive në bashkëpunim me arsimtarët, prindërit dhe nxënësit. **“Punoj edhe individualisht me fëmijët. Disa arsimtarë e kuptojnë mirë këtë mbështetje, konsultohemi se për cilën pjesë ka nevojë për ndihmë, ku të kushtoj më tepër vëmendje. Kjo lloj mbështetjeje është mirë të jetë në arsimin fillor, por disa fëmijë nuk kanë marrë me të vërtetë edhe punët elementare. Ndërsa edhe një pjesë e arsimtarëve mendojnë se fëmija duhet të punojë gjithçka me mua. Jo, puna e tij është mësimi, unë duhet ta ndihmoj sa të mundem. Por mendoj se një pjesë e mësuesve nuk e kuptojnë këtë”,** thotë një nga defektologët, pjesëmarrës në fokus grupin. Defektologët ballafaqohen përditë me paragjykime dhe refuzime nga arsimtarët për punë me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Një defektolog, pjesëmarrës në fokus grupin, ja se si na e ilustron këtë dukuri: **“Ende ekziston një rezistencë tek arsimtarët, disa, dua të them, që nuk duan të punojnë me nxënësit me aftësi të kufizuara. Thonë ‘çfarë është ky inkluzioni, na e sollët Iskrën (shkollë për personat me aftësi të kufizuara)’. Dhe për mua është sfidë të punoj me këta arsimtarë.”**

Një pjesë e defektologëve në vizitat në terren, deklaroi se mbështetjen nga arsimtarët e sigurojnë nëpërmjet trajnimeve interne: **“Arsimtarët nuk kanë mundësi të tjera për trajnim jashtë nga këto trajnimet interne të cilat i bëj unë. Madje edhe për punët elementare – të**

**dinë çfarë është disleksia, çfarë do të thotë aftësi e kufizuar... Ato trajnime që i kanë, janë për arsimtarët e shkollave fillore, për ato të shkollave të mesme nuk ka asgjë. Konsideroj se ky është një lëshim.”**

Kapacitetet jo të plota të shërbimeve profesionale dhe mungesa e defektologëve në shkolla e bën më të vështirë dhe më të papritur punën me nxënësi me aftësi të veçanta arsimore. Përfaqësuesi i një shkolle që është në fokus grupin deklaroi: **“Në shërbimin tonë pedagogjik ka vetëm pedagog. Me vite kemi kërkuar të punësojnë edhe psikolog, por pa sukses. Çfarë të bëjë më parë ai pedagog, çfarë mund të bëjë vetë?”**

Pa marrë parasysh përfshirjen e defektologëve në shërbimet profesionale, në përgjithësi, është i nevojshëm përforcimi i kapaciteteve të shërbimeve profesionale për punë me nxënësit me aftësi të kufizuara. Domethënë, si tërësisht të aftësuar për punë me nxënësit me aftësi të kufizuara (dhe pa nevojë për trajnime shtesë) janë vetëvlerësuar vetëm 3 për qind të shkollave:



- Shërbimi profesional është tërësisht i aftësuar për punë me nxënësit me NVA dhe nuk ka nevojë për trajnime shtesë.
- Shërbimi profesional i përparon vazhdimisht njohuritë dhe shkathtësitë për punë me nxënësit me NVA
- Shërbimi profesional ka nevojë për përparim të njohurive dhe shkathtësive për punë me nxënësit me NVA
- Përparimi i njohurive dhe shkathtësive për punë me nxënësit me NVA nuk është prioritet për shërbimin profesional

#### **PASQYRA 20:**


Përgjigjet e pyetjes "Në aspektin e përsosjes së shërbimit profesional për punë me nxënësit me aftësi të kufizuara, Ju lutemi shënoni se cili pohim e reflekton më mirë gjendjen në shkollën Tuaj"

Arsimtarët kanë theksuar nevojën për trajnim shtesë për punë me nxënësit me aftësi të kufizuara. Vetëm 1 për qind e shkollave kanë thënë se arsimtarët e tyre janë tërësisht të aftësuar për mësimdhënie inkluzive. Nevoja për trajnim të kuadrit arsimor dhe profesional lindi edhe gjatë vizitave në terren, si dhe gjatë fokus grupeve. Madje edhe vetë defektologët konsideronin se u nevojiten trajnime më të përparura shtesë në lidhje me mbështetjen e arsimtarëve në punën me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Shërbimet profesionale ku nuk ka defektolog konsiderojnë, gjithashtu, se u nevojiten aspekte shtesë në fusha të

ndryshme: identifikimi i fëmijës me aftësi të kufizuara, mundësitë dhe mënyrat e punës me fëmijë me lloje të ndryshme të kufizimeve, mënyra e dhënies mbështetje për arsimtarët dhe prindërit etj. Temat më të përmendura ishin: përpilimi dhe zbatimi i planit individual arsimor (PIA), vlerësimi i nxënësve të cilët punojnë sipas PIA-së, komunikimi dhe bashkëpunimi me prindërit, roli dhe mënyra e funksionimit të shërbimeve shkollore inkluzive. Arsimtarët thonë se duhet të njihen me termet themelore si: kufizime, lloje të kufizimeve, inkluzion, qasje individuale.

Theksi është vendosur te fakti se trajnimet duhet të jenë praktike dhe të zbatueshme. Pjesëmarrësit në fokus grupin me arsimtarë theksojnë: *“Arsimtarëve dhe shërbimeve profesionale u nevojitet trajnim. Po, edhe neve na nevojitet trajnim – nuk mund t’u japim mbështetje arsimtarëve, kur edhe vetë nuk e dimë se çfarë të bëjmë. Ja, në shkollën time nuk kemi defektolog, kurse unë me kolegen as që kemi mësuar për këtë çështje, dhe as nuk kemi pasur më parë përvojë... Si t’u themi ne tani arsimtarëve çfarë të bëjnë? Nuk e dimë si përpilohet PIA-ja – as ne dhe as ata. Ose si t’i mbrojmë fëmijët nga*

*shqetësimi seksual? Ata janë fëmijë në pubertet, ka shumë gjëra të ndryshme, kush do ta mbajë përgjegjësinë nëse ndonjërit prej fëmijëve me aftësi të kufizuara i ndodh diçka. Duhet të trajnohemi edhe për këto gjëra.”; “Duhet të trajnohen të gjithë arsimtarët të cilët kanë nxënës me aftësi të kufizuara. Në të vërtetë, duhet të trajnohen të gjithë arsimtarët, sepse, siç po shkojnë punët, po na vijnë gjithnjë edhe më shumë nxënës me aftësi të kufizuara. Nëse dikush nuk punon sot me një nxënës të tillë, kjo nuk do të thotë se nesër nuk do të ketë në klasë ndonjë fëmijë.”*




- Arsimtarët janë tërësisht të aftësuar të punojnë me nxënës me NVA dhe nuk nevojiten trajnime shtesë
- Arsimtarët i përparojnë vazhdimisht njohuritë dhe shkathtësitë për punë me nxënësit me NVA
- Arsimtarët nuk kanë nevojë për përparim të njohurive dhe shkathtësive për punë me nxënësit me NVA
- Përparimi i njohurive dhe shkathtësive për punë me nxënësit me NVA nuk është prioritet për arsimtarët

#### PASQYRA 21:

Përgjigjet e pyetjes “Në aspektin e aftësimin të arsimtarëve për punë me nxënësit me kufizime, Ju lutemi shënoni se cili pohim e pasqyron më mirë gjendjen në shkollën Tuaj”



Në aspektin e mjeteve të cilat i kanë në dispozicion shkollat, vetëm një për qind (një shkollë) ka marrë mjete shtesë për nxitjen e përfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara:




#### **PASQYRA 22:**

Përgjigjet e pyetjes: “A ka marrë shkolla Juaj mjete financiare nga pushtetet lokale apo nacionale që ta përparojë përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në vitin e fundit shkollor (2016/17)?”

Në pyetësor, shkolla ka vendosur se e ka shfrytëzuar këtë mundësi dhe mjetet i ka përdorur për blerje të mjeteve për ushtrime dhe për pajisje të banjave.

#### **Përvoja dhe praktika**

Në aspektin e përpilimit dhe zbatimit të planeve individuale arsimore, gjendja është si vijon:



### PASQYRA 23:

Përgjigjet e pyetjes “A përpunohen dhe zbatohen në shkollën Tuaj, për nxënësit me aftësi të kufizuara plane individuale arsimore?”

Sipas përgjigjeve të pyetësorit, 34 shkolla thonë se përpilojnë PIA për nxënësit e vet me nevoja të veçanta arsimore. Planin i ndjek nevojat, anët e forta të nxënësit dhe mundësitë për përshtatje të mësimdhënies në përputhje me dallimet dhe aftësitë individuale. Ky mjet edhe pse është i dobishëm dhe shumë i nevojshëm, vështirësia me të cilën ballafaqohen arsimtarët është mungesa e njohurive për përpilimin e tij, përkatësisht mungesa e formatit dhe modelit të unifikuar për zbatim në çdo shkollë. Përpunimi i PIA-së lidhet shpesh me mbështetjen nga defektologu dhe nevoja që prindi të jetë dakord për zbatimin e planit. Në asnjë rast nuk është shënuar pjesëmarrja e nxënësit në përpilimin e PIA-së.

Kjo pyetje është përfshirë edhe në fokus grupet. Një pjesëmarrës në fokus grupin për arsimtarë thotë: **“Në shkollën nga 1 deri në 5, arsimtarëve do t’u jepja 2 për**

**njohuritë dhe shkathhtësitë. U nevojitet mbështetje rreth qasjes individuale, përgatitjes dhe zbatimit të PIA-së, krijimit të klimës së këndshme për pranim nga klasa, për përforsim të nxënësit me aftësi të kufizuara që të mos ndjehet se ndryshon nga të tjerët.”**

Planin individual arsimor arsimtarët e përpilojnë sipas një formati të përcaktuar paraprakisht. Ata nuk janë gjithmonë të motivuar për punë me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe shpesh plani individual arsimor merr karakteristikën e një dokumenti i cili duhet të ekzistojë, por për përpilimin dhe zbatimin e tij nuk ka një qasje siç duhet të jetë në të vërtetë. Këtë e pohon edhe deklarata e defektologut gjatë vizitës në terren: **“Nuk ekzistojnë sfida të veçanta në lidhje me PIA-në. Ka arsimtarë që janë shumë të arsyeshëm, por disa e zbatojnë pa vullnet PIA-në. Për të gjithë është problem vlerësimi:**



***‘Do t’i vë tresh, por të mësojë diçka, a ka mundësi kështu?’ Ne mandej përgatitemi me nxënësen, është shumë e gëzuar kur arrin ta përvetësojë materialin, të përgjigjet dhe të marrë notë të mirë. Por këto përshtatje i bëjmë vetë me një pjesë të arsimtarëve, nuk jemi tërësisht të sigurt si duhet të veprojmë.’***

Sipas të dhënave të marra nga hulumtimi anketues/pyetësori dhe nga vizitat në terren, shkollat zbatojnë PIA për ata nxënës për të cilët kanë notë dhe vlerësim të marrë nga institucioni relevant. Instruksione të tilla kanë marrë nga inspektorët arsimorë – se PIA bëhet vetëm për fëmijët për të cilët shkollat kanë marrë “diagnozë dhe mendime, vërejtje mjekësore apo ndonjë dokument tjetër”. Një nga shkollat gjatë vizitës në terren deklaroi: ***“Pothuajse të gjitha shkollat kanë vështirësi me përpilimin e PIA-së dhe ndjekjen e saj, ndërkaq sidomos në aspektin e vlerësimit.”*** Këtë e pohoi edhe një pjesëmarrës në fokus grupin me arsimtarë: ***“Përpilojmë PIA, duhet ta bëjmë. Gjendemi, pyesim kolegë, sinqerisht, ndonjëherë planet i bëjmë që të jemi të mbuluar para inspektoratit, sepse shikojnë – a ke PIA për nxënësit me diagnozë dhe mendim. Se çfarë ke në PIA – atë as inspektorët nuk e shohin.”***


Një nga shkollat, që nuk ka shërbim profesional të kompletuar, por ka vetëm psikolog, shfrytëzon kapacitetet e asistentëve personalë të nxënësve të vet që të sigurojë mbështetje gjatë përpilimit të PIA-së dhe realizimit të mësimdhënies. Në shkollë ka të angazhuar dy defektologë, nga familjet, si asistentë personalë të fëmijëve të tyre. Kjo e dhënë është marrë gjatë vizitës në terren.

Fokus grupi i zbatuar me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore ka vërtetuar se: një numër i madh nxënësish nuk e njohin termin plan individual arsimor, që flet për faktin se edhe pse duhet të marrin pjesë dhe të jenë pjesë e ekipit i cili e përpilon planin, ata megjithatë nuk konsultohen, përkatësisht ndoshta nuk u është shpjeguar si duhet se për çfarë bëhet fjalë. Mandej, kuptimi i PIA-së si një dokument i rëndësishëm, te nxënësit varet nga lloji dhe shkalla e kufizimit. ***“Unë punoj sipas planit individual arsimor në orët e vizatimit, sepse e kam të vështirë të ngjyros dhe të vizatoj me dorë”*** pohoi një nxënëse me aftësi fizike të kufizuara.

Nxënësit, më shpesh, mbështetjen të cilën e marrin e lidhin me zgjidhjen praktike, reale, dhe jo me plane. ***“Anglishten e kam të vështirë dhe prandaj mësoj me defektologun.”; “Më vështirë e kisha me matematikën, prandaj bëja teste me rethem. Gjithashtu edhe fizikën, prandaj përpiloja prezantime”*** – deklaruan nxënësit, pjesëmarrës në fokus grupin.

Një problem i madh me të cilin ballafaqohen shkollat është edhe vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, të cilët ndjekin mësimin sipas planit individual arsimor:





#### PASQYRA 24:

Përgjigjet e pyetjes “Ju lutemi shënoni atë pohim që e reflekton më mirë gjendjen në shkollën Tuaj në aspektin e zbatimit të testeve të përshtatura si mjet për vlerësim.”

Përdorimi i testeve të përshtatura është mundësi për vlerësim të nxënësve sipas PIA-së. Sipas të dhënave të marra nga hulumtimi anketues, 34 shkolla e zbatojnë këtë mundësi. Përshtatjet bëhen në lidhje me kohën dhe zgjidhjen e testit, shpejtësinë, cilësinë dhe përmbajtjen e informacioneve të cilat pritet që t’i sigurojë nxënësi, si dhe në lidhje me sasinë e përgjigjeve të marra.

Këto përshtatje bëhen sipas mundësive individuale të nxënësit dhe shpesh e ndjekin dëshirën dhe vullnetin e arsimtarit që të zbatojë adaptime për nxënësin e vet. Nuk janë të përcaktuara në nivel të obligimit.

Gjatë vizitave në terren morëm përshtypjen se arsimtarët nuk i vlerësojnë

shpesh nxënësit sipas PIA-së që të mos ketë reagime të nxënësit e tjerë. Kjo çështje di të shkaktojë ndjenjë të padrejtësisë midis nxënësve të tjerë në të njëjtën paralele. Ata thonë se i ulin kriteret edhe për nxënësit e tjerë dhe i mundon pyetja: *A i përvetësojnë nxënësit me aftësi të kufizuara shkathtësitë e nevojshme që të jenë konkurrentë në tregun e punës, përkatësisht a janë shfrytëzuar tërësisht kapacitetet e nxënësve të tjerë dhe a zhvillohen në ngritje?* – dilemë të cilën e paraqiti një bashkëpunëtor profesional gjatë një vizite në një shkollë të mesme, ndërsa doli edhe si konstatim gjatë vizitave në terren dhe gjatë fokus grupeve. Kjo dilemë u hap arsimtarëve dhe prindërve pyetje të tjera që lidhen me ndërtimin dhe zhvillimin e shkathtësive

nëpërmjet arsimit me të cilat nxënësit me aftësi të kufizuara do të ishin konkurrentë në tregun e hapur të punës.

Sipas të dhënave të marra nga fokus grupi me nxënësit, vlerësimi është tema mbi të cilën nxënësit me nevoja të veçanta arsimore nuk mendojnë shumë. Ata thonë se arsimtarët i shpërblejnë për punën e tyre dhe se i vlerësojnë si edhe nxënësit e tjerë, përkatësisht ndonjëherë marrin nota të cilat janë më të larta. Kjo flet për faktin se arsimtari ndonjëherë e përdor vlerësimin si mjet motivues, përkatësisht, nxënësit me aftësi të kufizuara e pranojnë vlerësimin dhe realisht nuk nxiten aftësitë e tyre, për shkak të pritjeve më të vogla të cilat i kanë arsimtarët, si dhe bashkënxënësit prej tyre. Në këtë mënyrë nxënësi me kufizime dhe mjedisi ku mëson nuk krijojnë një pamje të vërtetë mbi mundësitë dhe kapacitetet reale të cilat i kanë në dispozicion. Nxënësit, pjesëmarrës në fokus grupin thonë: *“Unë ua lë profesorëve vlerësimin, unë mësoj, kurse ata vlerësojnë.”*; *“Disa arsimtarë na bëjnë lëshime.”*

Në kundërshtim me këtë, prindërit në fokus grupin deklaruan se kanë vënë re raste ku këta nxënës lihen pas dore. Prej tyre kërkohet të përvetësojnë vetëm gjërat themelore, edhe pse kanë mundësi për më tepër. Në lidhje me testet mendojnë se arsimtarët i përshtatin pjesërisht testet, përkatësisht ka raste ku arsimtarët janë këshilluar me ta në lidhje me përshtatjen e testeve, si dhe raste ku një nxënës në një test të papërshtatur ka marrë notën njësh.


Në parim, arsimtarët e grupit të fokusit deklaruan se vetë gjenden në lidhje me përshtatjen e testeve ose me mbështetje

të defektologëve dhe/ose shërbimeve profesionale.

Një arsimtar thotë: *“A i lejohet që të bëjë përshtatje arsimtarit? Neve inspektori na tha ‘duhet t’i përshtatni qëllimet dhe metodat, testi është test’.”*

Përvoja e një arsimtari tjetër, pjesëmarrës në fokus grupin është krejt ndryshe: *“Nënkuptohej që është e lejuar dhe duhet të përshtatet testi. Te ne bëhen teste të veçanta për nxënësit që mësojnë sipas PIA-së. Por këtu rolin kryesor e ka arsimtari, i cili duhet të vlerësojë sa dhe çfarë duhet të pyesë fëmijën. Përndryshe disa fëmijë i pyesim vetëm me gojë, nëse kanë probleme me motorikën; përshtatje është edhe të japë përgjigje vetëm me shkrim, nëse kështu përputhet me kërkesat e nxënësit. Por vlerësimi është problem i madh. Reagojnë edhe nxënësit edhe arsimtarët. Këtu nuk e dimë si të veprojmë saktësisht.”*

Nxënësit me aftësi të kufizuara kanë qasje të kufizuara të pajisjet ndihmëse kur përdorin kompjuter në klasë:



Vetëm 8 shkolla kanë shkruar se nxënësit e tyre kanë mundësi të përdorin teknologji ndihmëse gjatë punës me kompjuterë.

Përfshirja e nxënësve me aftësi të kufizuara në aktivitete dhe në përmbajtje jashtë shkollore është e kufizuar:

#### PASQYRA 25:

Përgjigjet e pyetjes: "A përdorin nxënësit me aftësi të kufizuara në shkollën tuaj pajisje ndihmëse (tastaturë me butona të mëdhenj, trakboll, xhojstik, klikim të veçantë, ekran me prekje etj.) ose përshtatje softuerike (përshtatje të mausit, ekranit etj.) gjatë punës me kompjuter?"

I pranojnë si bashkënxënës të barabartë, u ndihmojnë gjatë aktiviteteve mësimore dhe jashtë shkollore dhe shoqërohen me ta edhe jashtë shkollës.	26	29,9%
Sillen me ta me respekt dhe i shkëmbejnë materialet shkollore, por interaksioni është kryesisht i kufizuar në aktivitetet shkollore.	24	27,6%
Ekziston komunikim i kufizuar, sepse nxënësit me aftësi të kufizuara konsiderojnë se nxënësit me aftësi të kufizuara nuk mund të marrin pjesë në të njëjtat argëtime dhe lojëra.	5	5,7%
Nxënësit me aftësi të kufizuara nuk janë të pranuar dhe nuk marrin pjesë në jetën sociale të bashkënxënësve të tyre.	0	0%
Nxënësit me aftësi të kufizuara ofendohen dhe përqeshen nga bashkënxënësit e tyre.	1	1,1%
Nuk ka nxënës me aftësi të kufizuara në shkollën tonë.	33	37,9%
Tjetër (Ju lutemi shkruajeni):	4	4,6%

#### PASQYRA 26:

Përgjigjet e pyetjes "Ju lutem shënoni pohimin që e reflekton më mirë gjendjen në shkollën Tuaj në aspektin e pjesëmarrjes së nxënësve me aftësi të kufizuara në aktivitetet shkollore të lira dhe jashtë shkollore (seksione, gara, ekskursione, festa etj.).?"

Komente me përshkrim kanë dhënë 5 shkolla të cilat janë diametralisht të ndryshme. Disa thonë se nxënësit pranohen në mënyrë të barabartë, madje edhe jashtë mësimit. Të tjerë përshkruajnë nxënësit "të cilët nuk futen në grupin me nevoja të veçanta arsimore, por janë të mbyllur, jokomunikativë, të tërhequr, të turpshëm", ata theksojnë se në raport me ta, nxënësit e tjerë në ndonjë moment sillen në mënyrë të barabartë dhe i mbështesin ata, kurse në ndonjë moment ka përqeshje dhe kufizim në komunikim."

Të dhëna të ngjashme janë marrë edhe gjatë vizitave në terren, si edhe gjatë fokus grupeve. Ekziston dakordim midis prindërve dhe arsimtarëve se pranimi është gjatë orës së mësimit, jashtë klasës, duke përfshirë edhe oborrin e shkollës, nxënësit me aftësi të kufizuara nuk janë të pranuar. Ndodh shumë rrallë që të jenë të ftuar në ndonjë ditëlindje, festë, argëtim jashtë shkollës. Ende ekziston stigmë dhe mosbesim në aftësitë dhe mundësitë e nxënësve me aftësi të kufizuara. *"Shumica e fëmijëve tanë me të vërtetë nuk mund të marrin pjesë në shfaqje apo ndonjë seksion, thjeshtë kjo është jashtë mundësive të tyre."* - thotë një prind.

Një prind tjetër thotë *"Konsideroj se djali im nuk është pranuar si nxënës i barabartë me të tjerët, nuk e keqtrajtojnë, por e trajtojnë si fëmijë me nevoja të veçanta."*

Nxënësit theksuan se gjatë qëndrimit në shkollë janë të kënaqur nga marrëdhënia me shokët e tyre. Janë të pranuar dhe nuk hasin vështirësi në atë pjesë. *"Unë kam shoqe që nga shkolla fillore me të cilat më vunë në të njëjtën klasë dhe vazhdojmë të shoqërohemi."*; *"Kur nuk mund të më*

*ngrejë nëna ime na ndihmojnë shokët, madje edhe ata që mësojnë në paralelet shqiptare."* - thonë dy nxënëse me aftësi fizike të kufizuara. *Njëra prej tyre nuk ka mundur të shkojë në ekskursion për shkak se objekti ku duhej të qëndronin nuk ka pasur qasje për të: "Desha të shkoj në ekskursionin shumë ditor, por vendi ku duhej të qëndronim nuk ishte i kapshëm për mua."*

Pranimi të nxënësit krijon një ndjenjë të këndshme dhe thonë se nxënësve u pëlqen më tepër shoqërimi me moshatarët, njohjet e reja dhe orët e mësimit praktik.

Sipas të dhënave nga fokus grupi me arsimtarë, vlerësimi është se bashkënxënësit i tolerojnë nxënësit me aftësi të kufizuara, i ndihmojnë në mësim, por nuk krijojnë lidhje më të ngushta me ta jashtë shkolle. *"U shpjegojmë se duhet të jenë më të durueshëm, të jenë të gatshëm që t'i ndihmojnë dhe t'i mbështesin nxënësit me kufizime, kurse sidomos i këshillojmë të mos i tallin apo ngacmojnë. Këtë zakonisht e bëjmë së bashku me udhëheqësit e klasës."*; *"Nuk ka probleme të mëdha midis fëmijëve, por nuk shoqërohen shumë. Është e rrallë të shikosh apo dëgjosh se kanë dalë së bashku me një nxënës me aftësi të kufizuara, se kanë qenë në kinema apo në ndonjë festë së bashku... Në mësim apo kur janë në shkollë i ndihmojnë, u shpjegojnë, u japin materiale që t'i fotokopjojnë, por më duket se fëmijët me aftësi të kufizuara nuk shoqërohen me bashkënxënësit e tyre jashtë shkollës."* - thonë arsimtarët.

Kur bëhet fjalë për reagimin më të shpeshtë të prindërve të nxënësve që nuk kanë aftësi të kufizuar në lidhje me

përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuar në klasat, shkollat e rregullta, pjesa më e madhe e pranon përfshirjen e tyre.

E pranojnë përfshirjen e tyre si nxënës të barabartë dhe i nxitin fëmijët e vet që të shoqërohen, të bashkëpunojnë dhe t'i mbështesin nxënësit me aftësi të kufizuara.	17	19,1%
E pranojnë përfshirjen e tyre.	26	29,2%
Nuk kanë ose nuk tregojnë qëndrim në lidhje me përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara	12	13,5%
Nuk e pranojnë përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara, duke konsideruar se kjo e zvogëlon cilësinë dhe dinamikën e procesit arsimor, por nuk ndërmarrin iniciativa në lidhje me këtë.	1	1,1%
Ndërmarrin aktivisht iniciativa në shkollë dhe tek instancat e tjerë për çregjistrim të nxënësve me aftësi të kufizuar nga klasat e fëmijëve të vet.	0	0%
Nuk ka nxënës me aftësi të kufizuar në shkollën tonë.	35	39,3%
Tjetër (Ju lutemi shkruajeni):	2	2,2%

#### **PASQYRA 27:**

Përgjigjet e pyetjes “Si sillen më shpesh nxënësit e tjerë ndaj nxënësve me aftësi të kufizuar (shënojeni atë pohim që e reflekton më mirë gjendjen në shkollën Tuaj)?”

Shkollat për pyetësin kanë dhënë 3 përgjigje me përshkrim, prej të cilave vetëm një shkollë thotë se ka vënë re reagim negativ. Këtë e shpjegon si më poshtë: *“Nëse nxënësi me aftësi të kufizuara është agresiv ndaj nxënësve dhe arsimtarëve, prindërit nuk e pranojnë përfshirjen.”*

Këto të dhëna janë vërtetuar edhe gjatë vizitave në terren dhe gjatë fokus grupeve. Sipas përgjigjeve, shkollat nuk kanë masa të veçanta për nxitjen e pranimin të nxënësve me aftësi të kufizuara nga prindërit e bashkënxënësve të tyre. Ekzistojnë përvoja të ndryshme,

por në përgjithësi dominojnë ato pozitivet, edhe pse ekzistojnë edhe raste të rralla ku prindërit nuk janë senzitivizuar për konceptin kufizim dhe inkluzion. *“Këtu nuk mund të bëjmë shumë. Vjet, kur prindërit mësuuan se në klasën e tyre është një vajzë që lëviz dhe flet me vështirësi, kuptohet, por ka një të folur të ngadalshme, nuk ka kufizime intelektuale, nxënësja është super.. Nuk kishte reagim të hapur, por 7-8 fëmijë u çregjistruan nga klasa e saj, menjëherë në fillim të vitit, kërkuan të kalojnë në klasa të tjera. Nuk kishte çfarë të bënim, ashtu vepruam, ndërsa e dinim që ky*

**është reagim ndaj nxënëses me aftësi të kufizuara.** – thotë një pjesëmarrës në fokus grupin me arsimtarë.

Komente me përshkrim kanë dhënë 5 shkolla të cilat janë diametralisht të ndryshme. Disa thonë se nxënësit pranohen në mënyrë të barabartë, madje edhe jashtë mësimit. Të tjerë përshkruajnë nxënës **“të cilët nuk futen në grupin me nevoja të veçanta arsimore, por janë të mbyllur, jokomunikativë, të tërhequr, të turpshëm”; ata theksojnë se në raport me ta, nxënësit e tjerë në ndonjë moment sillen në mënyrë të barabartë dhe i mbështesin ata, kurse në ndonjë moment ka përqeshje dhe kufizim në komunikim.”**

Mandej, gjatë grupit të fokusit me nxënës, ata theksuan se kur qëndrojnë në shkollë janë të kënaqur nga marrëdhënia me shokët e tyre ndaj tyre. Janë të pranuar

dhe nuk hasin vështirësi në atë pjesë. **“Unë kam shoqe që nga shkolla fillore me të cilat më vunë në të njëjtën klasë dhe vazhdojmë të shoqërohemi.”; “Kur nuk mund të më ngrejë nëna ime na ndihmojnë shokët, madje edhe ata që mësojnë në paralelet shqiptare.”**

Kjo atmosferë për nxënësit krijon një ndjenjë të këndshme dhe ata thonë se në shkollë më shumë pëlqejnë shoqërimin me moshatarët, miqësitë e reja dhe orët praktike.

Kur bëhet fjalë për reaksionet më të shpeshta nga ana e prindërve të nxënësve pa aftësi të kufizuara në lidhje me përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në klasat e rregullta, shumica e shkollave u përgjigjën se ata i pranojnë nxënësit me aftësi të kufizuara. Vijon pasqyra tabelare me përgjigjet e prindërve që tregon se prindërit:

E përkrahin përfshirjen e këtyre nxënësve si nxënës me të drejta të barabarta dhe i inkurajojnë fëmijët e tyre që të shoqërohen, të bashkëpunojnë dhe t'i ndihmojnë nxënësit me aftësi të kufizuara.	17	19,1%
E pranojnë përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara.	26	29,2%
Nuk kanë ose nuk shprehin qëndrim rreth përfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara.	12	13,5%
Nuk e pranojnë përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara për shkak se mendojnë që kjo e zvogëlon cilësinë dhe dinamikën e procesit arsimor, por nuk ndërmarrin iniciativa në lidhje me këtë çështje.	1	1,1%
Ndërmarrin aktivisht iniciativa në shkollën dhe instancat e tjera për çregjistrim të nxënësve me aftësi të kufizuara nga klasat ku mësojnë fëmijët e tyre.	0	0%
Nuk ka nxënës me aftësi të kufizuar në shkollën tonë.	35	39,3%
Tjetër (ju lutem shkruajeni):	2	2,2%

#### **PASQYRA 28:**

Përgjigjet e pyetjes “Cili është reagimi më i shpeshtë i prindërve të nxënësve pa nevoja të posaçme në lidhje me përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në klasat e rregullta?”

Shkollat kanë dhënë 3 përgjigje përshtuese, nga të cilat vetëm një shkollë tregon arsyen për reagimet e prindërve: nëse nxënësi me aftësi të kufizuara është agresiv ndaj nxënësve dhe arsimtarëve, ata nuk e pranojnë përfshirjen. Të dhëna të ngjashme u prezantuan edhe në vizitat në terren dhe në fokus grupet. Sipas përgjigjeve, shkollat nuk kanë masa specifike për të inkurajuar përfshirjen

e nxënësve me aftësi të kufizuara nga prindërit e shokëve të tyre të klasës.

Në lidhje me pyetjen “me cilët subjektë shoqërorë ka pasur shkolla juaj bashkëpunim”, shkollat kryesisht i kanë përmendur shkollat fillore prej të cilave kanë ardhur nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Ata deklaruan gjithashtu se kishin bashkëpunim:

me shkolla të tjera të mesme	25	33,8%
me institucione shtetërore arsimore dhe me institucione të tjera relevante	9	12,2%
me shkolla fillore prej të cilave kanë ardhur nxënësit me aftësi të kufizuara	41	55,4%
me organizata të shoqërisë civile	15	20,3%
me komunën	23	31,1%
me institucione të tjera lokale	14	18,9%
shkolla nuk ka pasur bashkëpunim me subjektë të tjerë	17	23%

#### **PASQYRA 29:**

Përgjigjet e pyetjes “Me cilët subjektë shoqëror ka bashkëpunuar shkolla Juaj për avancim të përfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara (mund të përzgjidhni disa opsione)?”

Nga përgjigjet e pranuar, 48 shkolla kanë përshtuar bashkëpunimin dhe arritjet. Bashkëpunimi përfshin organizatat e shoqërisë civile, qendrat ditore, shkollat fillore, të mesme dhe ato speciale, autoritetet shtetërore dhe lokale, punonjësit shëndetësor etj. Si arritje të rëndësishme, shkollat theksojnë: përmirësimin e procesit arsimor, përmirësimin e gjithëpërfshirjes, përmirësimin e cilësisë së njohurive dhe aftësive të arsimtarëve për identifikimin dhe punën me këta nxënës.

Në përgjithësi, gjatë vizitave në terren, shkollat theksuan se është më e vështirë të bashkëpunohet me subjektët relevantë në sigurimin e mbështetjes për përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara. Bashkëpunimi nuk është i vazhdueshëm dhe zakonisht lidhet me ngjarjet për kremtim të datave të rëndësishme, ditët ndërkombëtare dhe festime të ngjashme.

Në lidhje me pyetjen për të pasqyruar përvojën e tyre nga puna me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, shkollat i kanë përzgjedhur këto opsione:

Shumica e nxënësve me aftësi të kufizuara i përvetësojnë njohuritë e parashikuara themelore dhe e mbarojnë arsimin e mesëm të rregullt.	34	48,6%
Nxënësit me aftësi të kufizuara e mbarojnë arsimin e mesëm të rregullt, por shumica e tyre nuk i përvetësojnë njohuritë e parashikuara themelore.	17	24,3%
Nxënësit me aftësi të kufizuara nuk mund ta ndjekin mësimdhënien dhe e ndërpresin arsimin e mesëm të rregullt.	1	1,4%
Shkollat e mesme speciale ofrojnë mundësi dhe kushte më të mira për nxënësit me aftësi të kufizuara.	18	25,7%

### PASQYRA 31:

Përgjigjet e pyetjes "cili prej opsioneve të ofruara reflekton më shumë përvojën e shkollës suaj në punën me nxënësit me aftësi të kufizuara?"

Sipas të dhënave të grumbulluara nëpërmjet anketës, 48.6% e shkollave mendojnë se nxënësit me nevoja të veçanta arsimore fitojnë njohuritë e parapara bazë pas përfundimit të arsimit të mesëm. Është me rëndësi fakti që 25.7% e shkollave konsiderojnë se shkollat e mesme speciale ofrojnë mundësi dhe kushte më të mira për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Vizitat në terren dhe fokus grupet na konfirmojnë: Me kapacitetin dhe resurset që i kanë në dispozicion, shkollat konsiderojnë se ato nuk ofrojnë mundësi të barabarta arsimore për nxënësit me aftësi të kufizuara. Duket se mendimi mbizotërues është se për një pjesë të nxënësve do të ishte më mirë të shkojnë në shkolla speciale. Veçanërisht theksohet problemi se ka nxënës që e mbarojnë arsimin fillor pa fituar njohuri dhe shkathtësi elementare (siç janë leximi dhe shkrimi). *"Jo. Në situatën aktuale, ne punojmë vetëm si kujdestarë të fëmijëve, arsimtarët punojnë duke tentuar dhe gabuar"; "Disa nxënës vetëm kanë kaluar*

*nëpër arsimin fillor, por nuk kanë mësuar asgjë. Ata nuk dinë si të lexojnë dhe të shkruajnë. Çfarë bëjmë me ata? Vetëm i kalojnë ata nxënës nga një klasë në tjetrën, nëse nuk dinë si të lexojnë, nuk mund të mësojnë as lëndët e tjera, nuk mund të mësojnë materialin. Ata duhet të marrin bazën në arsimin fillor, por nuk e kanë fituar. Prindërit e fëmijëve që kanë shkuar në shkollën fillore të rregullt nuk duan të dëgjojnë për një shkollë të mesme speciale."* - thanë pjesëmarrësit në fokus grupet.

Për këtë fakt flasin edhe përgjigjet e anketës në lidhje me arsimin e mesëm gjithëpërfshirës. Shkollat konsiderojnë se:



Arsimi i mesëm gjithëpërfshirës është i domosdoshëm dhe në favor të mirë të të gjithë fëmijëve.	27	32,1%
Arsimi i mesëm gjithëpërfshirës është mundësi e përshtatshme vetëm për një pjesë të nxënësve me aftësi të kufizuara, të cilët mund ta ndjekin procesin mësimor dhe të marrin pjesë në atë.	55	65,5%
Arsimi i mesëm gjithëpërfshirës nuk është në favor as për nxënësit me aftësi të kufizuara, as për nxënësit e tjerë.	3	3,6%

### PASQYRA 32:

Përgjigjet e pyetjes “Cili prej opsioneve të ofruara më shumë e përshkruan qëndrimin e shkollës suaj në lidhje me arsimin e mesëm gjithëpërfshirës?”

Gjithsej 8 (9.4%) e shkollave kanë thënë se ndryshimet në kornizën ligjore janë një nga tri nevojat prioritare që do të kontribuojnë më shumë për të promovuar gjithëpërfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollën e tyre. 6 shkolla ofrojnë rekomandime konkrete për lehtësimin e praktikës përfshirëse, siç janë procedurat për regjistrim të nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin e rregullt (klasifikimi dhe niveli i nxënësit, ndonjë dokument që përshkruan gjendjen e nxënësit etj.) dhe përgatitje e një rregulloreje me udhëzimet për përdorim, përgatitje, format, aplikim dhe raportim për planin individual të arsimit (PIA), si dhe rekomandime në pjesën e arsimit të detyrueshëm d.m.th. propozim që arsimi i mesëm për nxënësit me aftësi të kufizuara të mos jetë i obligueshëm.

Një shkollë ofron një propozim konkret se në kornizën e ndryshuar ligjore duhet të parashikohet edhe mbështetja për punësim të personave me aftësi të kufizuara pas mbarimit të shkollës së mesme.

Shtatë nga shkollat japin edhe sugjerime në lidhje me tri nevojat prioritare për mbështetjen e arsimit gjithëpërfshirës, të cilat përfshijnë sigurimin e transportit dhe asistentit, ekspertiza dhe angazhim më të madh të shërbimit profesional në shkollat, shkëmbimin e përvojave të defektologëve të punësuar në shkollat e rregullta të mesme me kolegë nga vendit dhe jashtë vendit, punësimi i defektologëve dhe përgatitje e një rregulloreje për planin individual të arsimit (PIA).

trajtime për arsimtarët për punë me nxënësit me aftësi të kufizuara	70	82,4%
trajtime për shërbimin profesional për punë me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe për mbështetje të arsimtarëve	55	64,7%
përmirësim i qasjes fizike në objektin shkollor	21	24,7%
sigurim i mjeteve të adaptuara pedagogjike-didaktike, mjete ndihmëse dhe teknologji ndihmëse kompjuterike (pajisje ndihmëse kompjuterike dhe softuer i adaptuar arsimor)	43	50,6%
sigurim i librave dhe materialeve të përshtatura (Brill, versione të përshtatura elektronike etj.)	17	20%
sigurim i më shumë mjeteve financiare për shkollën për plotësim të nevojave individuale arsimore të nxënësve me aftësi të kufizuara	31	36,5%
të punësohet defektolog në shkollën	49	57,6%
ndryshime në kornizës ligjore	8	9,4%

### PASQYRA 33:

Përgjigjet e pyetjes “ju lutemi t’i shënoni tri nevojat prioritare të cilat, sipas jush, nëse zgjidhen në mënyrë të përshtatshme, do të kontribuojnë më shumë në avancimin e gjithëpërfshirjes (inkluzionit) të nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollën tuaj?”



## „Informacione ose propozime shtese në lidhje me punën me nxënësit me aftësi të kufizuara“

Në fund të pyetësorit, i pyetëm shkollat të japin informacione dhe propozime shtesë në lidhje me punën me nxënësit me aftësi të kufizuara. Më shumë se një e treta e shkollave (38) kanë dhënë mendimet e tyre mbi propozimet për përmirësim të përfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollat e mesme. Përgjigjet e tyre janë në drejtim të:

- Ngritje e vetëdijes për arsimin gjithëpërfshirës në shkolla dhe në mjedis nëpërmjet organizimit të trajnimeve, tribunave, ligjëratave etj.;
- Zhvillim i programeve mësimore nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit (BZHA) sipas llojit të aftësisë së kufizuar;
- Trajnime për arsimtarët dhe shërbimet profesionale për punë me nxënësit me aftësi të kufizuara;
- Ekipim i shërbimeve profesionale me të gjitha profilet e nevojshme;
- Përgatitje e rregulloreve ligjore që do të rregullojnë përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara;
- Materialet për arsimtarët dhe shërbimin profesional (udhëzues, literatura, etj.);
- Përcaktimin e procedurave të regjistrimit për nxënësit me aftësi të kufizuara (për të specifikuar se cilët nxënës mund të përfshihen në arsimin e rregullt, kritere të qarta për vlerësimin e pikave të nxënësve me aftësi të kufizuara gjatë regjistrimit etj.);
- Organizim i aktiviteteve për përmirësimin e bashkëpunimit me prindërit e nxënësve me aftësi të kufizuara;
- Bashkëpunim aktiv dhe transferim i informacioneve ndërmjet shkollave filllore dhe të mesme;
- Sigurim i burimeve financiare shtesë për shkollat të cilat do të përdoren për sigurim të qasjes, pajisjeve dhe materialeve që do të synojnë lehtësimin e praktikës gjithëpërfshirëse;
- Përmirësimi i bashkëpunimit të shkollave me institucionet arsimore, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), Byroja për Zhvillimin e Arsimit (BZHA), Inspektorati Shtetëror i Arsimit (LSI) etj



## KONKLUZIONET

Konkluzioni i përgjithshëm i studimit thekson se gjithëpërfshirja në arsimin e mesëm në këtë fazë është reduktuar në një zbatim të improvizuar që është pasojë e një kuptimi sipërfaqësor dhe vetinterpretimi i konceptit të inkluzionit. Mungesa e pajtueshmërisë ligjore dhe e zbatimit konsekuent të ligjeve ekzistuese, përgatitja e pamjaftueshme e kushteve dhe e stafit që punon me nxënësit me aftësi të kufizuara, shërbimet profesionale të pakompletuara, niveli i ulët i ndërgjegjësimit për nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara ndikojnë mbi mundësitë e barabarta arsimore për të gjithë. Shkollat shpesh ofrojnë masa të paplota dhe zbatimi i tyre reduktohet në “pro forma” që nuk rezulton me efekte pozitive. Mungesa e standardeve të përcaktuara saktësisht çon në pritje të ulëta dhe një pamje joreale të inkluzionit si proces. Ky përfundim bazohet në konkluzionet e mëposhtme konkrete:

- Legjislacioni nuk është plotësisht në përputhje me dispozitat e dokumenteve kryesore ndërkombëtare në këtë fushë: Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventa e “Salamankës”. Kjo përfshin të drejtën për regjistrim në shkollë (akses) të nxënësit me aftësi të kufizuara në arsimin e rregullt të mesëm.
- Nuk ka mekanizëm për identifikim sistematik, evidentim dhe monitorim të nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin e rregullt të mesëm. Nga njëra anë, kjo redukton në masë të madhe mundësitë e tyre arsimore, dhe nga ana tjetër e bën të vështirë planifikimin e politikave arsimore.



- Mbështetja për inkluzionin është kryesisht vetëm deklarative. Nuk sigurohen burime të mjaftueshme buxhetore për të mbështetur përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin e rregullt të mesëm.
- Edhe pse qasja në arsim është kuptuar kryesisht në kuptimin fizik, madje edhe qasja fizike nuk është siguruar në mënyrë të mjaftueshme: Kryesisht është bërë me instalim të një rampe për akses në shkollën, duke neglizhuar standardet, por shumë pak është bërë për aksesin nëpër shkollë dhe mjete të përshtatura didaktike, d.m.th. pajisje në shkollat për mësimdhënie gjithëpërfshirëse.
- Pavarësisht nga përvojat pozitive të pilotimit të teknologjisë ndihmëse (si rezultat i një iniciative të shoqërisë civile), roli i teknologjisë bashkëkohore të informacionit dhe komunikacionit, si një mjet për përfshirje arsimore është lënë pas dore pothuajse tërësisht.
- Nuk përdoren resurset e adaptuara didaktike, nuk ka në dispozicion tekste dhe libra në format Brill ose në format audio ose sipas standardeve për qasje në ueb. Nuk ka kornizë adekuate ligjore për këtë çështje.
- Mësuesit nuk kanë njohuri dhe shkathtësi adekuate në aspektin e punës me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe individualizimin e mësimdhënies. Vështirësi e veçantë është zhvillimi dhe zbatimi i planeve individuale të arsimit dhe notimi i nxënësve që punojnë sipas një plani individual të arsimit. Nuk ka qasje të unifikuar për këtë çështje.
- Ekipet inkluzive nuk kanë rol dhe kompetenca të mjaftueshme. Formimi i tyre është kryesisht vetëm proforma. Përveç kësaj, ligji aktual (i cili përcakton detyrimin për të formuar ekipe shkollore inkluzive) sugjeron që ekipet e tilla duhet të formohen në shkolla të mesme speciale.
- Nuk ka mbështetje të mjaftueshme për inkluzion në opinionin e përgjithshëm dhe opinionin ekspert. Një nga efektet është mospërdorimi i shkollave speciale dhe të kapacitetit të tyre si qendra resurse për të mbështetur inkluzionin në arsimin e rregullt.
- Nuk ekzistojnë mekanizma për ndarjen e përvojave dhe praktikave të mira mes shkollave, shërbimeve profesionale dhe arsimtarëve. Nuk ka mekanizma për shkëmbimin e informacioneve dhe koordinimin ndërmjet niveleve të ndryshme të arsimit (për shembull, arsimin fillor dhe të mesëm).
- Nuk ka njohuri të mjaftueshme për nevojat, aftësitë dhe mundësitë e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në shkollë, në publikun e ngushtë dhe më të gjerë.
- Ka përfshirje shumë të ulët të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe të familjeve të tyre në proceset që kërkojnë pjesëmarrjen e tyre aktive si partnerë: vlerësimin e aftësive, mundësive dhe nevojave, krijimi i plan individual të arsimit dhe përshtatjen e mjedisit dhe mjeteve shkollore.
- Nxënësit me nevoja të veçanta arsimore janë përfaqësuar minimalisht me pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet jashtëshkollore.

## REKOMANDIME

Në bazë të konkluzioneve, u formuluan rekomandime të ndara në disa fusha ku duhen bërë ndryshime:

### 1. Rekomandime për përmirësim të kornizës ligjore me të cilën po rregullohet arsimi i mesëm:

- Ndryshimet në legjislacion për harmonizimin e plotë të legjislacionit kombëtar me dokumentet kryesore ndërkombëtare në këtë fushë: Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventa e "Salamankës". Ndryshimet ligjore duhet të përgatiten në një proces participativ, duke i përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, shoqërinë civile, mësuesit dhe përfaqësuesit e shërbimeve profesionale të shkollave të mesme, ekspertët dhe profesionistët etj.
- Në Ligjin për Arsimin e Mesëm duhet të përcaktohet e drejta për regjistrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin e mesëm të rregullt, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Arsimi i rregullt duhet të identifikohet si alternativa e parë për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe jo si përjashtim.
- Të krijohet mekanizëm për identifikim sistematik, regjistrim dhe monitorim të nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin e mesëm të rregullt (dhe në arsim në përgjithësi).
- Autoritetet kompetente të arsimit duhet të monitorojnë dhe të angazhohen në reformën e vazhdueshme të procesit

të përcaktimit të llojit dhe shkallës së aftësisë së kufizuar, në përputhje me Klasifikimin ndërkombëtar të funksionalitetit, aftësisë së kufizuar dhe shëndetit. Mbështetja në arsimin e mesëm të rregullt (dhe në arsim në përgjithësi) duhet të përshtatet me aftësitë dhe nevojat individuale të fëmijëve dhe të rinjve.

- Të sigurohen mjete të mjaftueshme buxhetore për të mbështetur inkluzionin e nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin e mesëm të rregullt. Të zhvillohet një sistem transparent dhe i përgjegjshëm për shpërndarjen e fondeve në shkollat e mesme që do të mundësojë përdorim efektiv, efikas dhe objektiv të fondeve.

### 2. Rekomandime për përmirësim të kushteve dhe kapaciteteve për zbatim të arsimit gjithëpërfshirës dhe krijim të mundësi të barabarta për të gjithë:

- Të sigurohet akses i plotë fizik në objektet shkollore në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë ambientet dhe pajisjet e brendshme me pajisje didaktike të nevojshme dhe materiale për mësim gjithëpërfshirës. Në këtë drejtim, është e nevojshme të vendosen standarde për qasjen në objektet shkollore, pajisjet dhe procesin mësimor, në përgjithësi.
- Të parashikohen dhe të krijohen kushte për përdorim të teknologjisë bashkëkohore të informacionit dhe komunikimit si një mjet për inkluzion, duke përfshirë zhvillimin e aplikacioneve të adaptuara arsimore në gjuhët mësimore në vend.



- Tekstet dhe materialet e tjera edukative të ofrohen në format Brill, në format audio dhe të jenë të adaptuara në përputhje me standardet për qasje në internet. Me ligj dhe me akte nënligjore, duhet të përcaktohet se autorët duhet të dorëzojnë të gjitha materialet në MASH në formë elektronike në përputhje me standardet ndërkombëtare për qasjen në internet.
  - Të trajnohen vazhdimisht arsimtarët për punën në arsimin gjithëpërfshirës dhe individualizimin e mësimdhënies. Në këtë kontekst, fakultetet pedagogjike duhet të shqyrtojnë mundësinë e ndryshimit të programeve mësimore dhe të nisin me metodologji të ndryshme për mësimdhënie dhe mësim, që ta përforcojnë përfshirjen e arsimit dhe mësimdhënien inkluzive. Gjithashtu, arsimtarët që tashmë punojnë në arsim duhet të trajnohen sidomos në zhvillimin dhe zbatimin e PIA dhe verësim të nxënësve që punojnë sipas një plani individual të arsimit.
  - Të krijohet një koncept dhe model i qartë për rolin e defektologut në shërbimin profesional në shkollat e mesme. Në të njëjtën kohë duhet të hartohen dhe zbatohen aktivitete për forcimin profesional dhe trajnim të defektologëve që punojnë në arsimin e mesëm të rregullt.
  - Në mënyrë sistematike, të përcaktohet roli dhe përgjegjësitë e ekipeve inkluzive në shkollat dhe të sigurohen trajnime dhe mjete që ata të jenë në gjendje për të kryer rolin e synuar, gjithashtu të parashikohet përfshirja e detyrueshme e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara në ekipet inkluzive në shkollat e mesme të rregullta dhe qartësisht të theksohet se ekipet inkluzive duhet të formohen në shkollat e mesme të rregullta.
  - Të identifikohen dhe të promovohen praktika dhe modele të suksesshme të inkluzionit në shkollat e mesme të rregullta, si dhe të krijohen mekanizma për shkëmbim të përvojave dhe praktikave pozitive mes shkollave, shërbimeve profesionale dhe arsimtarëve.
3. [Rekomandime për përfshirje më të madhe të nxënësve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre në ngjarjet shkollore, jashtëshkollore dhe sociale:](#)
- Të senzibilizohen shkollat, komuniteti i ngushtë dhe më i gjerë për nevojat, mundësitë dhe aftësitë e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore përmes punëtorive, tribunave publike dhe debateve dhe ngjarjeve inkluzive.
  - Të mundësohet përfshirja më e madhe e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe familjeve të tyre në procesin e vlerësimit të mundësive, në krijimin e një plani individual të arsimit dhe në propozimin e përshtatjeve dhe zgjidhjeve sipas mundësive dhe aftësive individuale.
  - Të ofrohen mundësi të ndryshme dhe të stimulohet pjesëmarrja e nxënësve me aftësi të kufizuara në aktivitete jashtëshkollore, gara dhe ekskursione.



SHTOJCA

# SHTOJCA 1

## LISTA E DOKUMENTEVE

Objekt i analizës në kuadër të hulumtimit janë dokumentet në vijim:

- Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (Ligji për ratifikim të Konventës për të Drejtat e Personave me Invaliditet dhe Protokolli Fakultativ si shtojcë i Konventës për të Drejtat e Personave me Invaliditet),
- Deklarata e UNESCO-s për Arsim të Bazuar mbi Nevojat e Posaçme nga Salamanka (Deklarata e Salamankës),
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës,
- Ligji për Arsim të Mesëm,
- Ligji për Arsim dhe Trajnim Profesional,
- Ligji për Mësuesit në Shkollat Fillore dhe të Mesme,
- Ligj për Shërbimin Pedagogjik,
- Ligji për Librat Shkollorë për Arsim Fillor dhe të Mesëm,
- Ligji për Standardin e Nxënësve,
- Strategjia Nacionale për të Drejtat e Barabarta të Personave me Invaliditet (e reviduar) nga viti 2010 deri në vitin 2018.

# SHTOJCA 2

## PYETËSOR

### për shkollat e mesme të rregullta

Emri i shkollës së mesme:: \_\_\_\_\_

Lloji i arsimit:

- gjimnaz                       profesional                       gjimnaz dhe profesional

e tjerë (ju lutem shënoni): \_\_\_\_\_

Vendi i banimit: \_\_\_\_\_ Komuna: \_\_\_\_\_

Gjuha mësimore në shkollën (nëse duhet, përzgjidhni disa opsione):

- gjuha maqedonase     gjuha shqipe  
 gjuha turke               gjuha serbe

1. Ju lutemi shkruani **numrin total të nxënësve të regjistruar** në shkollën tuaj dhe struktura e tyre sipas gjinisë në vitin shkollor aktual dhe të kaluar.

Numri i nxënësve në	meshkuj	femra	gjithsej
vitin aktual shkollor 2017/18:			
vitin e kaluar shkollor 2016/17:			

2. Ju lutemi shkruani **numrin total të nxënësve me aftësi të kufizuara** në shkollën tuaj dhe struktura e tyre sipas gjinisë në vitin shkollor aktual dhe të kaluar.

Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara në:	meshkuj	femra	gjithsej
vitin aktual shkollor 2017/18:			
vitin e kaluar shkollor 2016/17:			

3. **Struktura etnike e nxënësve** në vitin aktual shkollor 2017/18 (shkruani numrat e nxënësve):

- Maqedonas    \_\_\_\_\_     Shqiptarë:    \_\_\_\_\_     Turq:    \_\_\_\_\_  
 Romë    \_\_\_\_\_     Serbë:    \_\_\_\_\_     Vllehë:    \_\_\_\_\_  
 Boshnjakë:    \_\_\_\_\_     E tjerë:    \_\_\_\_\_

4. Ju lutemi shkruani **numrin total të nxënësve me aftësi të kufizuara** në shkollën tuaj dhe struktura e tyre sipas **vitit të arsimit të mesëm** në vitin shkollor aktual dhe të kaluar.

Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara në:	Viti				gjithsej
	I parë	I dytë	I tretë	I katërt	
vitin aktual shkollor 2017/18:					
vitin e kaluar shkollor 2016/17:					

5. Sa prej nxënësve tuaj me aftësi të kufizuara të regjistruar në vitin aktual shkollor 2017/18 përballohen me **aftësitë e kufizuara në vijim (shkruani numrin e nxënësve)?**

<input type="checkbox"/> <b>nxënës me aftësi të kufizuara intelektuale:</b> (pengesa në zhvillimin psikik)	
<input type="checkbox"/> <b>nxënës me aftësi të kufizuara fizike:</b> (nxënësit që kanë vështirësi për t'i lëvizur krahët, këmbët ose tërë trupin, nxënësit që kanë paralizë cerebrale, nxënësit që përdorin karroca ose mjete të tjerë ndihmëse për të lëvizur)	
<input type="checkbox"/> <b>nxënës me pengesa në shikim:</b> (Dëmtim nga një lloj më i vështirë që e pengon nxënësin të ndjekë mësimin)	
<input type="checkbox"/> <b>nxënës me pengesa në të dëgjuarit dhe/ose të folurit</b> (Dëmtim nga një lloj më i vështirë që e pengon nxënësin të ndjekë mësimin)	
<input type="checkbox"/> <b>nxënës me më shumë aftësi të kufizuara:</b> (kombinim i disa pengesave)	
<input type="checkbox"/> <b>nxënës me autizëm:</b> (rregullime të spektrit autik)	
<input type="checkbox"/> <b>nxënës me vështirësi në të mësuarit:</b> (hiperaktivitet, disleksia, disgrafia, diskalkulia etj.)	
<input type="checkbox"/> <b>e tjerë</b> (ju lutem shkruani):	

**6. Sa prej nxënësve tuaj me aftësi të kufizuar të regjistruar në vitin aktual shkollor 2016/17 u përballuan me aftësitë e kufizuara në vijim (shkruani numrin e nxënësve)?**

<input type="checkbox"/> <b>nxënës me aftësi të kufizuar intelektuale:</b> (pengesa në zhvillimin psikik)	
<input type="checkbox"/> <b>nxënës me aftësi të kufizuara fizike:</b> (nxënësit që kanë vështirësi për t'i lëvizur krahët, këmbët ose tërë trupin, nxënësit që kanë paralizë cerebrale, nxënësit që përdorin karroca ose mjete të tjerë ndihmëse për të lëvizur)	
<input type="checkbox"/> <b>nxënës me pengesa në shikim:</b> (Dëmtim nga një lloj më i vështirë që e pengon nxënësin të ndjekë mësimin)	
<input type="checkbox"/> <b>nxënës me pengesa në të dëgjuarit dhe/ose të folurit</b> (Dëmtim nga një lloj më i vështirë që e pengon nxënësin të ndjekë mësimin)	
<input type="checkbox"/> <b>nxënës me më shumë aftësi të kufizuara:</b> (kombinim i disa pengesave)	
<input type="checkbox"/> <b>nxënës me autizëm:</b> (rregullime të spektrit autik)	
<input type="checkbox"/> <b>nxënës me vështirësi në të mësuarit:</b> (hiperaktivitet, disleksia, disgrafia, diskalkulia etj.)	
<input type="checkbox"/> <b>e tjerë</b> (ju lutem shkruani):	

**7. Struktura etnike e nxënësve me aftësi të kufizuara në vitin aktual shkollor (shkruani numrin):**

- |                                     |       |                                     |       |                                  |       |
|-------------------------------------|-------|-------------------------------------|-------|----------------------------------|-------|
| <input type="checkbox"/> Maqedonas  | _____ | <input type="checkbox"/> Shqiptarë: | _____ | <input type="checkbox"/> Turq:   | _____ |
| <input type="checkbox"/> Romë       | _____ | <input type="checkbox"/> Serbë:     | _____ | <input type="checkbox"/> Vllehë: | _____ |
| <input type="checkbox"/> Boshnjakë: | _____ | <input type="checkbox"/> E tjerë:   | _____ |                                  |       |

**8. A ka ndodhur në tri vitet e fundit që shkolla juaj të mos jetë në gjendje të pranojë ndonjë nxënës me aftësi të kufizuara?**

po

jo

Nëse po, ju lutem shpjegojini **arsyet**:

---



---

**9. Në cilën mënyrë shkolla juaj i identifikon nxënësit me aftësi të kufizuara?**

Mund të shënoni më shumë se një opsion:

- prindërit kanë dorëzuar dokument (d.m.th. mendim mjekësore për llojin dhe shkallën e pengesës) nga institucion përkatëse për aftësinë e kufizuar me të cilën po përballohet nxënësi
- prindërit e kanë njoftuar shkollën gojarisht për aftësinë e kufizuar me të cilën po përballlet nxënësi
- nëpërmjet vlerësimit nga ana e shërbimit profesional, të arsimtarëve dhe prindërve e nxënësit
- nëpërmjet vlerësimit nga ana e shërbimit profesional dhe të arsimtarëve
- tjetër (ju lutemi shënoni): \_\_\_\_\_

---

**10. Farë përshtatjesh janë bërë për të siguruar qasje fizik në shkollën tuaj? Mund të shënoni më shumë se një opsion:**

- rampa aksesuese në hyrjen kryesore të objektit shkollor
- ashensor i jashtëm në hyrjen kryesore të objektit shkollor
- hapësira të përshtatura të brendshme në shkollën (p.sh. hapësirë për punë individuale me nxënësit me aftësi të kufizuara, sallë të përdorshme për nxënësit me aftësi të kufizuara etj.)
- tualete të adaptuara
- ashensor i brendshëm për lëvizje nëpër katet
- nuk janë ndërmarrë masat e nevojshme për lehtësim të qasjes për nxënësit me aftësi të kufizuara
- e tjerë (ju lutemi shënoni): \_\_\_\_\_

---



**11.** A ka në dispozicion shkolla juaj **mjete të adaptuara pedagogjike-didaktike dhe mjete ndihmëse?**

po

jo

Nëse po, ju lutemi shkruani se cilët janë ata: \_\_\_\_\_

---



---

**12.** A ka në dispozicion në shkollën tuaj **pajisje ndihmëse kompjuterike** (tastiera të zgjeruara, trakboll, leva (xhojstik), klikim i ndarë, ekran me të prekur etj.)?

po

jo

Nëse po, ju lutemi shkruani se cilat janë ato: \_\_\_\_\_

---



---

**13.** A ka **defektolog** në shërbimin profesional në shkollën tuaj?

- po, në shkollën tonë punon defektolog me kohë të plotë pune
- po, në shkollën tonë punon defektolog "lëvizës" (punon edhe në disa shkolla të tjera)
- po, në shkollën tonë punon defektolog – vullnetar
- jo

**14.** Ju lutemi shënoni se cilat **profile profesionale keni në shërbimin profesional** në shkollën tuaj:

- pedagog       psikolog       punëtor social
- defektolog       logoped

e tjerë (ju lutemi shënoni): \_\_\_\_\_

---



---

**15.** Në lidhje me **kualifikimin e shërbimit profesional për punë me nxënës me aftësi të kufizuara**, ju lutemi përzgjidhni opsionin që e përshkruan situatën më mirë në shkollën tuaj:

- shërbimi profesional është tërësisht i kualifikuar për punë me nxënës me aftësi të kufizuara dhe nuk ka nevojë për trajnime shtese
- shërbimi profesional i avancon vazhdimisht njohuritë dhe shkathtësitë për punë me nxënës me aftësi të kufizuara përmes trajnimeve dhe seminareve të ndryshme
- shërbimi profesional ka nevojë për avancim të njohurive dhe shkathtësive për punë me nxënës me aftësi të kufizuara, por nuk ofrohen mjaft mundësi për pjesëmarrje në trajnime dhe seminare nga kjo fushë
- avancimi i njohurive dhe shkathtësive për punë me nxënës me aftësi të kufizuara nuk është prioritet për shërbimin profesional

**16.** Në lidhje me **kualifikimin e arsimtarëve për punë me nxënës me aftësi të kufizuara**, ju lutemi përzgjidhni opsionin që më mirë e përshkruan situatën në shkollën tuaj:

- arsimtarët janë tërësisht të kualifikuar për punë me nxënës me aftësi të kufizuara dhe nuk kanë nevojë për trajnime shtese
- arsimtarët i avancojnë vazhdimisht njohuritë dhe shkathtësitë për punë me nxënës me aftësi të kufizuara përmes trajnimeve dhe seminareve të ndryshme
- arsimtarët kanë nevojë për avancim të njohurive dhe shkathtësive për punë me nxënës me aftësi të kufizuara, por nuk ofrohen mjaft mundësi për pjesëmarrje në trajnime dhe seminare nga kjo fushë
- avancimi i njohurive dhe shkathtësive për punë me nxënës me aftësi të kufizuara nuk është prioritet për arsimtarët

**17.** Në lidhje me **ekipin inkluziv** të shkollës për avancim të punës me nxënës me aftësi të kufizuara, ju lutemi përzgjidhni opsionin që më mirë e përshkruan situatën në shkollën tuaj:

- për çdo nxënës me aftësi të kufizuara formohet dhe funksionon një ekip inkluziv i cili përfshin prindin e nxënësit dhe kujdeset për nevojat e veçanta arsimore të nxënësit
- në shkollën tonë është formuar dhe funksionon një ekip inkluziv i cili përfshin një ose disa përfaqësues të nxënësve me aftësi të kufizuara dhe kujdeset për nevojat e veçanta arsimore të nxënësve
- në shkollën tonë është formuar dhe funksionon një ekip inkluziv i përbërë vetëm prej disa nëpunësve të shkollës dhe kujdeset për nevojat e veçanta arsimore të nxënësve
- shkolla nuk ka formuar ekip inkluziv
- nuk ka nxënës me aftësi të kufizuara në shkollën tonë

**Ju lutem shkruani më shumë detaje në lidhje me:**

Cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të ekipit inkluziv në shkollën tuaj, nëse në shkollën tuaj funksionon një ekip i tillë?

Cilat janë arsytet pse nuk është formuar një ekip inkluziv (nëse në shkollën ka nxënës me aftësi të kufizuara)?

---



---



---

**18.** A ka fituar shkolla juaj **mjete financiare shtese** nga pushteti qendror ose lokal për avancim të përfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara në vitin e fundit shkollor (2016/17)?

- po     jo     nuk ka nxënës me aftësi të kufizuara në shkollën tonë

Nëse po, ju lutemi shkruani për çfarë i keni shfrytëzuar mjetet financiare:

---



---



---

**19.** A përgatiten dhe zbatohen **plane individuale të arsimit** për nxënësit me aftësi të kufizuara në shkollën tuaj?

- plani individual i arsimit përgatitet dhe zbatohet për çdo nxënës me aftësi të kufizuara për të gjithë lëndët mësimore në të cilët nxënësi ka vështirësi ta ndjek mësimdhënien e rregullt
- plani individual i arsimit përgatitet dhe zbatohet nga një pjesë e arsimtarëve lëndorë të cilët janë trajnuar për atë
- nuk përgatiten as zbatohen plane individuale të arsimit për nxënësit me aftësi të kufizuara
- nuk ka nxënës me aftësi të kufizuar në shkollën tonë

**Ju lutemi jepni më shumë detaje rreth këtyre pyetjeve:**

Cilat janë arritjet dhe sfidat kryesore në lidhje me përgatitjen dhe zbatimin e planeve individuale të arsimit?

Cilat janë arsyet pse nuk përgatiten plane individuale të arsimit (në raste kur në shkollën ka nxënës me aftësi të kufizuara)?

---



---



---

**20.** Në lidhje me **testet e adaptuara** si instrument për vlerësim, ju lutemi përzgjidhni opsionin që më mirë e përshkruan situatën në shkollën tuaj:

- testet adaptohen për të gjithë nxënës me aftësi të kufizuar
- testet adaptohen vetëm për nxënësit me aftësi të kufizuara që ndjekin mësimdhënie sipas një plani individual të arsimit
- nxënësit me aftësi të kufizuar vlerësohen me testet e njëjta që përdoren edhe me nxënësit e tjerë
- nuk ka nxënës me aftësi të kufizuara në shkollën tonë

Ju lutemi përshkruani nga se përbëhet adaptimi:

---



---



---

**21.** A ka në shkollën tuaj **pajisje informatike-ndihmëse** (tastiera të zgjeruara, trakboll, leva (xhojstik), klikim i ndarë, ekran me të prekur etj.) ose adaptime softuerike (adaptim i miut, ekranit etj.) **për punë në kompjuter?**

- po     jo     nuk ka nxënës me aftësi të kufizuara në shkollën tonë

Nëse po, ju lutemi shkruani se cilat pajisje ose adaptime softuerike po i përdorni:

---



---



---

**22.** Në lidhje me **pjesëmarrjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në aktivitetet jashtëshkollore** (seksione, gara, ekskursione, festime etj.), ju lutemi përzgjidhni opsionin që e përshkruan më mirë situatën në shkollën tuaj:

- shkolla i përgatit dhe i përshtat aktivitetet jashtëshkollore në mënyrë që mundëson pjesëmarrje të barabartë të nxënësve me aftësi të kufizuara, në përputhje me interesat e tyre personale
- nxënësit me aftësi të kufizuara përfshihen në pjesë të aktiviteteve jashtëshkollore, të cilave mund t'u përshtaten për shkak të aftësive të kufizuara
- nxënësit me aftësi të kufizuara nuk marrin pjesë në aktivitetet jashtëshkollore
- nuk ka nxënës me aftësi të kufizuara në shkollën tonë

**23.** Si **sillen** më shpesh **nxënësit e tjerë** me nxënësit me aftësi të kufizuara? (ju lutemi përzgjidhni opsionin që më mirë e përshkruan situatën në shkollën tuaj):

- i pranojnë si bashkënxënës të barabartë, i ndihmojnë në aktivitetet mësimore dhe jashtëshkollore dhe shoqërohen me ata edhe jashtë shkollës
- i trajtojnë me respekt dhe ndajmë më ata materiale për të mësuarit, por interaksioni është kryesisht i kufizuar në aktivitetet në shkollë
- ka komunikim të kufizuar për shkak se nxënësit pa aftësi të kufizuara mendojnë se nxënësit me aftësi të kufizuara nuk mund të marrin pjesë në lojërat dhe zbavitjet
- nxënësit me aftësi të kufizuara nuk janë pranuar dhe nuk marrin pjesë në jetën sociale së bashku me bashkënxënësit e tyre

- nxënësit me aftësi të kufizuar janë të ofenduar dhe tallur nga ana e shokët e tyre të klasës
- nuk ka nxënës me aftësi të kufizuara në shkollën tonë
- tjetër (ju lutemi shpjegoni): \_\_\_\_\_

---



---

**24.** Cili është **reagimi më i shpeshtë** i prindërve në lidhje me përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në klasat e rregullta?

- e përkrahin përfshirjen e këtyre nxënësve si nxënës me të drejta të barabarta dhe i inkurajojnë fëmijët e tyre që të shoqërohen, të bashkëpunojnë dhe t'u ndihmojnë nxënësve me aftësi të kufizuara
- e pranojnë përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara
- nuk kanë ose nuk shprehin qëndrim rreth përfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara
- nuk pranojnë përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara për shkak se mendojnë që kjo e zvogëlon cilësinë dhe dinamikën e procesit arsimor, por nuk ndërmarrin iniciativa për ta ndaluar inkluzionin
- ndërmarrin aktivisht iniciativa në shkollë dhe instanca të tjera për çregjistrim të nxënësve me aftësi të kufizuara nga klasat ku mësojnë fëmijët e tyre
- nuk ka nxënës me aftësi të kufizuar në shkollën tonë
- tjetër (ju lutemi shënoni): \_\_\_\_\_

---



---

25. Me cilët subjektë shoqërorë ka pasur shkolla juaj bashkëpunim për avancim të inkluzionit të nxënësve me aftësi të kufizuara? (mund të përzgjidhni disa opsione)

- me shkolla të mesme të tjera
- me shkolla fillore prej të cilave kanë ardhur nxënësit me aftësi të kufizuara
- me komunën
- me institucione të tjera lokale
- me institucionet shtetërore arsimore dhe me institucione të tjera relevante
- me organizatat e shoqërisë civile
- shkolla nuk ka pasur bashkëpunim me subjektë të tjerë

Ju lutemi shkurtimisht përshkruanin bashkëpunimin dhe arritjet:

---



---



---

26. Cili prej opsioneve të ofruar më shumë e reflekton **përvojën e shkollës suaj** në punën me nxënësit me aftësi të kufizuara?

- shumica e nxënësve me aftësi të kufizuara i përvetësojnë njohuritë e parashikuara themelore dhe e mbarojnë arsimin e mesëm të rregullt
- nxënësit me aftësi të kufizuara e mbarojnë arsimin e mesëm të rregullt, por shumica e atyre nuk i përvetësojnë njohuritë e parashikuara themelore
- nxënësit me aftësi të kufizuara nuk mund ta ndjekin mësimdhënien dhe e ndërpresin arsimin e mesëm të rregullt
- shkollat e mesme speciale ofrojnë mundësi dhe kushte më të mira për nxënësit me aftësi të kufizuara

27. Cili prej opsioneve të ofruara më shumë e përshkruan **qëndrimin e shkollës suaj** në lidhje me arsimin e mesëm gjithëpërfshirës?

- arsimi i mesëm gjithëpërfshirës është i domosdoshëm dhe në favor të mirë të të gjithë fëmijëve
- arsimi i mesëm gjithëpërfshirës është mundësi e përshtatshme vetëm për një pjesë të nxënësve me aftësi të kufizuara, të cilët mund ta ndjekin procesin mësimor dhe të marrin pjesë në atë
- arsimi i mesëm gjithëpërfshirës nuk është në favor as për nxënësit me aftësi të kufizuara, as për nxënësit e tjerë



**28.** Ju lutemi t'i shënoni **tri nevojat prioritare** të cilat, sipas jush, nëse zgjidhen në mënyrë të përshtatshme, do të kontribuojnë më shumë në avancimin e gjithëpërfshirjes (inkluzionit) të nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollën tuaj?

- të punësohet defektolog në shkollë
- trajnime për arsimtarët për punë me nxënësit me aftësi të kufizuara
- trajnime për shërbimin profesional për punë me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe për mbështetje të arsimtarëve
- përmirësim i qasjes fizike në objektin shkollor
- sigurim i mjeteve të adaptuara pedagogjike-didaktike, mjete ndihmëse dhe teknologji ndihmëse kompjuterike (pajisje ndihmëse kompjuterike dhe softuer i adaptuar arsimor)
- sigurim i librave dhe materiale të përshtatura (Brill, versione të përshtatura elektronike etj.)
- sigurim i më shumë mjeteve financiare për shkollën për plotësim të nevojave individuale arsimore të nxënësve me aftësi të kufizuara
- ndryshime në kornizës ligjore – Ju lutemi përshkruani më konkretisht:

---



---

- tjetër, ju lutem shkruani: \_\_\_\_\_
- 
- 

**29. Informacione shtese ose propozime** në lidhje me punën me nxënësit me aftësi të kufizuara:

---



---



---



---



---

<b>Emri dhe mbiemri:</b>	<b>Pozita pune në shkollën:</b>
_____	_____
<b>Informacione për kontakt të plotësuesit të anketës:</b>	
tel.: _____	celular: _____ e-mail: _____
<b>Data e plotësimit:</b>	<b>Nënshkrim dhe vulë:</b>
_____	_____

**JU FALEMINDERIT PËR BASHKËPUNIMIN!**

# SHTOJCA 3

## RAPORT

### nga vizita dhe intervista në shkollë

**Data:**

emri dhe mbiemri, pozita, informacione për kontakt

**Intervistuesi:**

**Personi/personat e intervistuar:**

1. (emri dhe mbiemri, pozita, informacione për kontakt)
- 2.
- 3.

TË DHËNAT PËR SHKOLLËN	
Emri i plotë i shkollës së mesme	
Vendi, komuna	
Rajoni	
Lloji i arsimit	<input type="checkbox"/> gjimnazial <input type="checkbox"/> profesional <input type="checkbox"/> gjimnazial dhe profesional <input type="checkbox"/> tjetër (shkruani):
Gjuha mësimore	<input type="checkbox"/> gjuha maqedonase <input type="checkbox"/> gjuha shqipe <input type="checkbox"/> gjuha turke <input type="checkbox"/> gjuha serbe

**1. Cili është numri i përgjithshëm i nxënësve të regjistruar në shkollën tuaj në vitin shkollor 2017/18?**

Numri i nxënësve	meshkuj	femra	gjithsej

**2. Cili është numri i përgjithshëm i nxënësve me aftësi të kufizuara të regjistruar në shkollën tuaj në vitin shkollor 2017/18?**

Numri i nxënësve	meshkuj	femra	gjithsej

**3. Sa nxënës me aftësi të kufizuara janë regjistruar në shkollën tuaj në çdo vit të arsimit të mesëm në vitin shkollor 2017/18?**

Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara në:	Viti				gjithsej
	I parë	I dytë	I tretë	I katërt	

**4. Sa nxënës me aftësi të kufizuara janë regjistruar në shkollën tuaj në vitin shkollor 2017/18 sipas llojit të aftësisë së kufizuar?**

Lloji i aftësisë së kufizuar	Numri i nxënësve
nxënës me aftësi të kufizuar intelektuale	
nxënës me aftësi të kufizuara fizike	
nxënës me pengesa në shikim	
nxënës me pengesa në të dëgjuarit dhe/ose të folurit	
nxënës me më shumë aftësi të kufizuara	
nxënës me autizëm (çrregullime të spektrit autik)	
nxënës me vështirësi në të mësuarit (hiperaktivitet, disleksia, disgrafia, diskalkulia etj.)	
e tjerë (nëse ka, ju lutem shkruani)	
gjithsej:	

**5. Cila është struktura etnike e nxënësve me aftësi të kufizuara të regjistruar në shkollën tuaj në vitin shkollor 2017/18?**

Komuniteti etnik	Numri i nxënësve
Maqedonas	
Shqiptarë	
Turq	
Romë	
Serbë	
Vllehë	
Boshnjakë	
E tjerë (nëse ka, shënoni)	
gjithsej:	

**6. Cila është arsyeja për mospërputhjet midis të dhënave aktuale dhe përgjigjeve që i keni dhënë në pyetësin më parë? A bëhet fjalë për ndryshim në numrin e nxënësve me aftësi të kufizuara ose e keni rishikuar vlerësimin?**

---



---



---

**7. Në cilën mënyrë shkolla përcakton se cilët nxënës janë me aftësi të kufizuara? Cilat burime informatash i përdorni? Në cilën mënyrë i përcaktoni dhe evidentoni nevojat e veçanta arsimore” të nxënësve?**

---



---



---

- 8. Ju lutemi përshkruani (nëse keni pasur ndonjëherë përvojë të tillë) situatë ku shkolla nuk ka qenë në gjendje të pranojë ndonjë nxënës me aftësi të kufizuara? Cilat ishin arsyet? Si e komunikuat këtë situatë me nxënësin dhe prindërit e tij?**

---

---

---

- 9. Çfarë përshtatjesh janë bërë që të sigurohet qasje fizike në shkollë? Me çfarë mjetesh (të adaptuara) pedagogjike-didaktike dhe mjetesh ndihmëse disponon shkolla? A ka në shkollën tuaj pajisje ndihmëse kompjuterike?**

Gjetje dhe vërejtje nga vrojtimit:

---

---

---

- 10. Cila është përbërja e shërbimit profesional të shkollës? Cili është roli i tij në punën me aftësi të kufizuara? A është trajnuar shërbimi profesional për rolin e parashikuar?**

---

---

---

- 11. A është kuadri mësimor i motivuar për punë me nxënës me aftësi të kufizuara dhe cilat janë sfidat me të cilat përballen zakonisht në punën? Çfarë trajnimesh kanë pranuar arsimtarët për punë me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe sa është numri i arsimtarëve që kanë pasur mundësi të marrin pjesë në këto trajnime në tri vitet e fundit?**

---

---

---

**12. A zbaton shkolla plane individuale të arsimit në punën me nxënësit me aftësi të kufizuara? Nëse po: Cilat janë arritjet? Cilat janë sfidat? Si po zhvillohet vlerësimi i nxënësve që mësojnë sipas një plani individual të arsimit? Nëse jo, pse nuk përgatiten dhe nuk zbatohen plane individuale të arsimit?**

---

---

---

**13. Kush e përbën ekipin inkluziv në shkollën tuaj që ka për qëllim avancimin e punës me nxënësit me aftësi të kufizuara? Sa prindër të nxënësve me aftësi të kufizuara janë përfshirë në këtë ekip? Si u përzgjedhën ata prindër? Cili është roli i prindërve në ekip? Cilat janë arritjet e ekipit inkluziv? Cilat janë sfidat? Nëse jo, pse?**

---

---

---

**14. Si bashkëpunon shkolla me prindërit e nxënësve me aftësi të kufizuara? Si siguron shkolla komunikim të rregullt dhe shkëmbim të informacioneve me prindërit e këtyre nxënësve? Si i përfshin shkolla prindërit në përmirësimin e mundësive arsimore për fëmijët e tyre? Cilat janë sfidat dhe mundësitë për avancim të bashkëpunimit me prindërit e nxënësve me aftësi të kufizuara?**

---

---

---

**15. Si i njofton shkolla institucionet kompetente lokale (komuna) si dhe institucionet shtetërore (MASH) për identifikimin e nxënësve me aftësi të kufizuara? A pranon shkolla mjete financiare shtese për avancim të përfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara?**

---

---

---



**16. Si e inkurajon shkolla përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në aktivitetet jashtëshkollore (seksione, gara, ekskursione, festime etj.)? Nëse nxënësit me aftësi të kufizuara nuk marrin pjesë në këto aktivitete, cilat janë arsyet?**

---

---

---

**17. Si sillen nxënësit pa aftësi të kufizuara me nxënësit me aftësi të kufizuara? Cilat janë sfidat? Si i inkurajon shkolla nxënësit pa aftësi të kufizuara t'i pranojnë dhe t'i mbështesin bashkënxënësit e tyre me aftësi të kufizuara?**

---

---

---

**18. Cili është qëndrimi i prindërve të nxënësve pa aftësi të kufizuara ndaj përfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara në klasat e rregullta? Cilat janë sfidat, a ka pasur deri tani ndonjë reagim dhe ankesë kundër përfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara? Si i nxit shkolla prindërit e nxënësve pa aftësi të kufizuara ta përkrahin përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin e rregullt të mesëm?**

---

---

---

**19. A bashkëpunon shkolla me subjektë të tjerë social (institucionet lokale dhe shtetërore, organizatat e shoqërisë civile, sektorin e biznesit, mediat, etj.) në drejtim të përmirësimit të përfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara? Nëse po: Me cilët subjektë? Çfarë ishte bashkëpunimi? Cilat janë arritjet? Nëse jo, a ka pasur ndonjë përpjekje për bashkëpunim? Me kë? Pse përpjekja për bashkëpunim nuk ishte e suksesshme? Nëse nuk ka pasur përpjekje për bashkëpunim, cilat ishin arsyet për këtë?**

---

---

---

**20. Cilat janë nevojat prioritare të shkollës në lidhje me avancimin e përfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara? Çfarë duhet të përmirësohet që të përforcohet kapaciteti i shkollës për të ofruar mundësi të barabarta për nxënësit me aftësi të kufizuara?**

---

---

---

**21. Informacione shtesë ose propozime në lidhje me punën me nxënësit me aftësi të kufizuara që doni t'i ndani me ne?**

---

---

---

**KOMENTE DHE VËREJTJE GJATË INTERVISTËS:**

---

---

---

---

---

## SHTOJCA 4:

### **PYETJET**

#### **për fokus grupin me prindërit e nxënësve me aftësi të kufizuara**

1. Në cilën shkollë të mesme mëson fëmija juaj? Në cilin vit? Pse keni vendosur të regjistrohemi në atë shkollë të mesme? A ishte kjo shkollë zgjedhja e parë e fëmijës suaj?
2. A ka hasur fëmija juaj vështirësi gjatë regjistrimit në shkollën e mesme? Nëse po, cilat vështirësi?
3. Si e vlerësoni qasjen në shkollë ku mëson fëmija juaj? A mund të lëvizë fëmija juaj në tërë objektin pa ndihmë? Nëse jo, kush i jep përkrahje kur shkon në shkollë?
4. A punon fëmija juaj sipas një plani individual të arsimit? Nëse po, a ju kanë konsultuar mësuesi / mësuesit që e kanë përpunuar atë plan gjatë përgatitjes së planit? Cili është mendimi juaj për planin individual të arsimit që përdor fëmija juaj? Nëse jo, a mendoni se fëmija juaj ka nevojë për një plan individual të arsimit?
5. Sa jeni të kënaqur me arritjet arsimore të fëmijës suaj? A mendoni se vlerësimi i arsimtarëve është objektiv dhe pasqyron punën e nxënësit?
6. Çfarë mendoni për mbështetjen e ofruar nga shërbimi profesional i shkollës? A merr fëmija juaj mbështetjen e nevojshme?
7. Si e vlerësoni mbështetjen që e merr fëmija nga mësuesit? A merr fëmija juaj mbështetjen e nevojshme?
8. Si e vlerësoni bashkëpunimin dhe komunikimin me shkollën në përgjithësi?
9. A konsultohet shërbimi profesional me ju në lidhje me nevojat dhe mundësitë arsimore të fëmijës suaj? A ju japin këshilla dhe udhëzime se si ju mund ta ndihmoni fëmijën tuaj në përvetësimin e përmbajtjeve mësimore?
10. A merr pjesë fëmija juaj në aktivitete jashtëshkollore (ekskursione, festime, gara, seksione, etj.)? Në cilat, në çfarë mënyre? A ekzistojnë aktivitete jashtëshkollore në të cilat fëmija juaj donte të merrte pjesë, por kjo nuk ishte e mundur?
11. Si sillen bashkënxënësit ndaj fëmijës suaj? A është pranuar fëmija juaj nga bashkënxënësit? A e ndihmojnë ata në përgjegjësitë e përditshme të shkollës? A shoqërohet fëmija juaj me bashkënxënësit jashtë shkollës?
12. Cili është qëndrimi i prindërve të bashkënxënësve të fëmijës suaj në

lidhje me përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin e rregullt të mesëm? A e pranojnë përfshirjen?

13. Çfarë mendoni se është më e mira për fëmijën tuaj në shkollë?
14. Çfarë mendoni se është sfida më e madhe për fëmijën tuaj në shkollë?

## PYETJET

### për fokus grupin me nxënësit me aftësi të kufizuara në arsimin e mesëm të rregullt

1. Në cilën shkollë të mesme mëson? Në cilin vit? Pse ke vendosur të regjistrohesh në atë shkollë të mesme? Ishte ajo shkollë zgjedhja juaj e parë?
2. A ke hasur vështirësi gjatë regjistrimit në shkollën e mesme? Nëse po, cilat vështirësi?
3. A lëviz vetë nëpër shkollë? Mund të shkosh në çdo klasë? Cilën klasë apo dhomë nuk mund ta vizitosh? Pse, shkurtimisht na thuaj arsyet dhe kufizimet.
4. A ke dëgjuar ndonjëherë për një plan individual të arsimit? A e ke parë se si duket? A përgatisin arsimtarët një plan të tillë për ty? A je përfshirë ti në përgatitjen e planit? A të kanë pyetur se çfarë mendon ti se mund të arrish prej asaj që e kanë planifikuar në plan? A e ke më të lehtë që të mësosh sipas këtij plani?
5. Sa je i/e kënaqur me arritjet në shkollë? Çfarë mendon për notat që

15. A do të dëshironte fëmija juaj ta vazhdojë arsimin në fakultet? Nëse po, çfarë do të studiojë? A mendoni se ka mundësi që fëmija juaj të vazhdojë arsimin? Cilat janë arsyet / pengesat që e pengojnë fëmijën të vazhdojë arsimin në fakultet?
16. Si mendoni se mund të përmirësohet përfshirja e nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin e rregullt të mesëm?

i japin mësuesit tuaj? A e dinë ata se çfarë mund të mësosh dhe çfarë e ke më të vështirë për të mësuar? A mendon se notat tuaja janë reale sipas njohurive dhe aftësive tuaja?

6. Sa je i/e kënaqur me sjelljen e mësuesve tuaj ndaj teje? A të japin mbështetjen që të nevojitet për të zotëruar përmbajtjen mësimore?
7. Çfarë mendon për mbështetjen e ekipit profesional në shkollë? A ke mbështetje kur ke nevojë për të? Sa e rëndësishme është kjo mbështetje për ty? Shkurtimisht përshkruaje mbështetjen.
8. A merr pjesë ti në aktivitetet jashtëshkollore (ekskursione, festime, gara, seksione, etj.)? Në cilat, në çfarë mënyre? A ka ndonjë aktivitet jashtëshkollor në të cilin ke dëshiruar të marrësh pjesë, por nuk ishte në mundësi?

9. Si sillen nxënësit në klasën tuaj ndaj jush? Ju lutem më trego një shembull apo një ngjarje nëpërmjet të cilës do të më tregosh se si sillen? Kujtohu për ndonjë ngjarje kur ke qenë i/e lumtur, por edhe për ndonjë situatë kur nuk je ndierë mirë. A të pranojnë ata? A të ndihmojnë gjatë detyrave të përditshme të shkollës? A shoqërohesh me ta jashtë shkollës?
10. Cili është qëndrimi i prindërve të shokëve të klasës tuaj në lidhje me përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin e rregullt të mesëm? A të pranojnë ata?
11. Cila është gjëja më e mirë për ty në shkollë?
12. Cila është sfida më e madhe për ty në shkollë?
13. Çfarë planifikon të bësh kur do ta mbarosh shkollën e mesme? A ke dëshirë që të shkosh në fakultet? Në cilin fakultet do të vazhdosh?
14. Si mendon se mund të përmirësohet përfshirja e nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin e rregullt të mesëm?

## PYETJET

### për fokus grupin me arsimtarët dhe përfaqësuesit e shërbimeve profesionale në shkollat

1. A keni punuar me nxënës me aftësi të kufizuara? Me çfarë lloj aftësish të kufizuara përballesh nxënësit tuaj?
2. Si i identifikoni nxënësit me aftësi të kufizuara? Si i përcaktoni nevojat e veçanta arsimore të nxënësve me aftësi të kufizuara?
3. Si e vlerësoni përgatitjen dhe trajnimin tuaj për të punuar me nxënësit me aftësi të kufizuara? Cilat trajnime po vizitoni, mbi cilat tema? Kur dhe prej kujt janë organizuar këto trajnime? Si ju ndihmuan trajnimet në punën tuaj të përditshme me nxënësit me aftësi të kufizuara? Në cilat tema mendoni se keni nevojë për trajnime shtese? Nëse jo, çfarë lloj trajnimi ju nevojitet?
4. Për sa prej nxënësve tuaj me aftësi të kufizuara përgatisni plane individuale të arsimit? A keni nxënës me aftësi të kufizuara për të cilët nuk përgatisni plane individuale të arsimit? Cilat janë arsyet për këtë? Në çfarë mënyrë po e bëni planin? Në çfarë mënyrë e ndiqni arritjen e planit dhe arritjet e nxënësit?
5. A përdorni teste të përshtatura për të vlerësuar njohuritë e nxënësve me aftësi të kufizuara (kryesisht ata që punojnë sipas një plani individual të arsimit)? Nëse po, përshkruani përshtatjet që i bëni? A ju ndihmon dikush që t'i përshtatni testet?

6. A keni resurset e nevojshme (mjetet didaktike-pedagogjike, mjetet ndihmëse, teknologjia asistive kompjuterike etj.) për punë me nxënësit me aftësi të kufizuara? Si e vlerësoni aftësinë tuaj për t'i përdorur ato? Nëse jo, çfarë mungon?
7. Cili është roli i shërbimeve profesionale në lidhje me përkrahjen e arsimtarëve që punojnë me nxënës me aftësi të kufizuara? Tregoni më shumë nga përvoja juaj.
8. Si e vlerësoni bashkëpunimin me prindërit e nxënësve me aftësi të kufizuara në avancimin e arsimit të këtyre nxënësve? Sa shpesh komunikoni me ata? Çfarë informacionesh shkëmbeni më shpesh? Në cilën mënyrë po komunikoni?
9. Si siguron përfshirjen e nxënësve tuaj me aftësi të kufizuara në aktivitetet jashtëmësimore (festime, gara, seksione, ekskursione etj.). Tregoni disa shembuj.
10. Në cilën mënyrë e inkurajoni pranimin e nxënësve me aftësi të kufizuara nga ana e bashkënxënësve të tyre? Në cilën mënyrë?
11. Në cilën mënyrë e inkurajoni pranimin e nxënësve me aftësi të kufizuara nga ana e prindërve të bashkënxënësve të tyre?
12. A mendoni se arsimit i mesëm i rregullt ofron mundësi të barabarta arsimore për nxënësit me aftësi të kufizuara? Ju lutemi shpjegoni.
13. Çfarë mendoni se është suksesi juaj më i madh në punën me nxënësit me aftësi të kufizuara? Cila është arsyeja për suksesin?
14. Çfarë mendoni se është sfida më e madhe në punën tuaj me nxënësit me aftësi të kufizuara? Si mund të tejkalohet?
15. A ka vazhduar në fakultet dikush prej nxënësve tuaj me aftësi të kufizuara? Në cilin fakultet? Me çfarë sukses dhe arritje? A ka dikush prej nxënësve tuaja për momentin që do të vazhdojë arsimin në fakultet? Si i vlerësoni shansat e këtij nxënësi për vazhdim të arsimit në fakultet?
16. Si mendoni se mund të përmirësohet gjithëpërfshirja në arsimin e mesëm të rregullt?





